


**RAPORTI PARAPRAK**  
**I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**  
**PER NENNJESINE STRUKTURORE C 2.2a /1**  
**BASHKIA BERAT**



VENDNDODHJA: NENNJESIA STRUKTURORE C 2.2 a/1, NE LAGJEN "30VJETORI"

PUNOI : Msc Inxh. RAIMINA HAKRAMA  
EKSPERTE MJEDISI

DHJETOR 2015



## **PERMBAJTJA**

### **1. HYRJE**

- 1.1 Shpjegimi I akronimeve
- 1.2 Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se

### **2. KUADRI LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL**

- 2.1 Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit
- 2.2 Legjislacioni Mjedisor

### **3. RAPORTI PARAPRAK I VNM-SE**

- 3.a) Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.
- 3.b) Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqene kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.
- 3.c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.
- 3.ç) Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si : ujera te ndotura, gaze, pluhur, zhurma, vibrime, si dhe prodhimin e mbetjeve.
- 3.d) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.
- 3.dh)Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.
- 3.e) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.
- 3.ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.
- 3.f) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar ( nese projekti ka natyre te tille).

## 1. HYRJJE

### 1.1 Shpjegimi i akronimeve

-“Cilësi e mjedisit” është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.

-“Dëmtim i mjedisit” është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.

-“Kapacitet bartës” është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore.

-“Mjedis” janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.

-“Mjedis i kërcënuar” është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.

-“Ndërhyrje negative në mjedis” është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.

-“Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësujë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.

-“Subjekt ndotës ose ndotës” është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.

-“Substancë e rrezikshme” është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t’u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.

-“Shkarkim” është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.

-“Gjendje e pranueshme e mjedisit” është gjendja në të cilën mjedisi i vendit në fjalë ishte para se instalimi të vihej në operim. Arritja e kësaj gjendjeje kërkon masa që përfshijnë, por nuk kufizohen me: largimin e të gjitha mbetjeve që kanë tepruar, largimin sa më shumë të jetë e mundur të çdo lloji ndotjeje, dhe, aty ku ky largim nuk do të thotë trajtim praktik apo stabilizim i ndotjes, rehabilitimin e çdo dëmi që mund të ketë shkaktuar ndotja, si dhe zbutjen e efekteve të çdo dëmi.

-“Instalim” është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me veprimtaritë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;

-“Instalim ekzistues” është: a) një instalim që është në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji; b) një instalim që nuk është vënë ende në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi, por për të cilin është dhënë leja e ndërtimit, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 119 datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, dhe ndërtimi i të cilit fillon brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

-“Instalim i ri” është: a) një instalim që nuk është instalim ekzistues; b) një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, ky instalim trajtohet si një instalim i ri.

-“Normat e cilësisë së mjedisit” është një grup kushtesh që duhen përmbushur në një kohë të dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjesë e veçantë e tij, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

-“Substancë” është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe të organizmave të modifikuar gjenetikisht, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

- “Shkarkim në ujë” janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.

- “Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)” është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundur, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

- “Biomasë” është produkt i përbërë, tërësisht ose pjesërisht, nga material bimor nga bujqësia ose pemëtaria, që mund të përdoret si lëndë djegëse, me qëllim rikuperimin e energjisë së përmbajtur në të.

- “Vlera kufi e shkarkimit” është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie, gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm<sup>3</sup>, duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 për qind, në rastin e karburanteve të lëngshme e të gazta, 6 për qind në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 për qind në rastin e turbinave me gaz.

- “Zhvillues” është personi ose autoriteti publik që kërkon miratim për të zhvilluar një projekt privat apo publik.

- “Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

- “Publiku” ka kuptimin që jepet në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

- “Publik i ndikuar” është publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF-të mjedisore që shprehin interes.

- “Vendim” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga AKM-ja, në të cilin është vendosur nëse një projekt i shtojcës II duhet apo jo të nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së.

- “Deklarata për ndikimin e një projekti në mjedis”, më poshtë “Deklarata mjedisore”, është dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri, për vlerësimin mjedisor të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të thelluar të ndikimit në mjedis dhe shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar dhe që përfshihet në kategorinë III.1 të shtojcës që i bashkëlidhet ligjit Nr. 10 081, date 23.2.2009 “Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë”.

- “Vlerësim ndërkufitar i ndikimeve në mjedis” është procesi i VNM-së, që zhvillohet për projekte ose veprimtari, të përcaktuara në aneksin I të Konventës së Kombeve të Bashkuara (ESPOO) “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”, që, bazuar nga vendndodhja e teknologjia e tyre, mund të kenë ndikime të ndjeshme negative në mjedisin e shteteve fqinje apo të vendit tonë.

- “Ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor

## ***1.2 Pershkrimi i qëllimit dhe objektivave të VNM-se***

Pothuajse nuk ka asnjë zhvillim me origjinë njerezore që mos të shkaktojë ndikim mjedisor, në shkallë të ndryshme. Kjo është arsyeja se pse tashme i është dhënë gjithmone e me shumë rëndësi aspekteve mjedisore të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë në terma të investimeve të propozuara. Bazuar në parimin mjedisor të “parandalimit” sipas të cilit çdo nderhyrje e planifikuar duhet të provojë paraprakisht që nuk do të ketë pasoja negative në mjedis, të gjitha vendet me legjislacion mjedisor bashkëkohor kryejnë atë që quhet Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) për çdo nderhyrje apo investim konkret.

Po ashtu, edhe politikat, planet, dhe programet mund të kenë ndikime mjedisore. Nëse nuk hartohen mbi baza të shëndosha parimore dhe mjedisore, planet apo projektet e mëdha mund të perfundojnë duke shkaktuar dëme mjedisore afatgjata.

Procesi i VNM-se është një detyrim ligjor. VNM-ja është një instrument i rëndësishëm për të integruar konsiderata mjedisore në përgatitjen dhe në miratimin e projekteve të caktuara, të cilat kanë të ngjarë që të kenë efekte domethënëse mbi mjedisin.

Objektivi kryesor i VNM-se paraprake është orientimi i Nennjesia Strukturore C 2.2a/1 për minimizimin e çdo ndikimi potencial negativ që mund të rezultojë nga zbatimi i tij. Kjo VNM paraprake identifikon ndikimet e mundshme mjedisore të Nennjesia Strukturore C 2.2a/1, vlerëson ndikimet e mundshme, jep rrugët e minimizimit apo shmangies së tyre. VNM-ja analizon disa skenare. Skenari "0", pra i "të mos bërit asgjë" e cila do të thote me shumë gjasa në një spirale të përsëritur të përkeqësimit mjedisor të deritanishëm. Në vend të kësaj, VNM-ja synon të orientojë këto projekt për realizimin e objektivave të tij në një mënyrë të qëndrueshme.

Për Nennjesia Strukturore C 2.2a/1, vlerësimi merret veçanërisht me ndikimin mjedisor që mund të ketë zbatimi i projektit. Siç u tha në paragrafin më sipër, skenari "0" nuk është zgjidhja e duhur, pasi gjendja aktuale mjedisore e zonës në studim e zgjeruar është ekstremisht e dobët po t'i referohemi standardeve evropiane, dhe do të përkeqësohet edhe me shumë mënyra vazhdon rritja e paplanifikuar.

Veçanërisht për Nennjesia Strukturore C 2.2a/1, ky vlerësim shqyrton aspektet mjedisore të zhvillimit të planit në lidhje me tendencat dhe situatën aktuale dhe bën një analizë të:

- mjedisit urban në teresin - përdorimit të tokës, floras, faunës, cilesisë së ajrit dhe ujit, rekreacionit aktiv dhe pasiv, hot-spotëve potenciale të ndotjes, zonave me bukuri natyrore apo me ndjeshmëri të vegante mjedisore, zonave potencialisht të ekspozueshme ndaj rreziqeve natyrore;
- mjedisit dhe trashëgimisë së ndërtuar - monumentet e godinat arkeologjike, kulturore dhe historike, aspektet dhe vlerat peizazhiste, qendrat historike të qytetit;
- veprimtarive ekonomike dhe shoqërore - të tilla si tregtia, industria, shëndeti dhe arsimit, si dhe ndikimi që këto kanë mbi mjedisin.
- infrastrukture dhe sigurimit të shërbimeve - sigurimi (burimor) i ujit, energjisë dhe telekomunikacioneve; menaxhimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëshueshme; qarkullimi dhe levizshmëria në rrugë dhe transport; levizshmëria alternative;

Raporti i vlerësimit paraprak mjedisor është bazuar në rëndësinë e hartimit të studimeve urbanistike rajonale dhe mjedisore me standarde bashkëkohore, duke mbajtur parasysh pasuritë natyrore dhe njerëzore të zonës në studim, vlerat e veçanta të tyre, si dhe kërkesat e pronarëve të zonës. Identifikimi i efekteve negative dhe pozitive dhe përcaktimi i masave zbutëse është bërë duke patur parasysh ruajtjen e interesave të investitorëve, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, si dhe përputhjen e zhvillimit ekonomik e social të zonës me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm. Për të arritur një vlerësim sa më real e të besueshëm të ndikimit në mjedis, duhet analizuar situata në aspekte të ndryshme si:

- Kuadri ligjor dhe administrativ;
- Plani rregullues;
- Pozicioni gjeografik dhe kufiri administrativ;
- Relievi i azhurnuar;
- Të dhënat klimaterike dhe hidrologjike;
- Të dhënat gjeologjike;
- Të dhënat mbi florën dhe faunën;
- Sizmiteteti i zonës;
- Resurset territoriale dhe ekonomike;
- Monumentet e kulturës, arkeologjike dhe historike të zonës;
- Të dhënat demografike aktuale dhe të perspektivës;
- Pronësia mbi trojet;

- Të dhëna mbi infrastrukturën (rrjeti rrugor, elektrik, telefonik, ujësjellës-kanalizimeve, mbledhja dhe trajtimi i mbetjeve urbane, etj.);
- Profili ekonomik;
- Shkalla dhe sektorët e punësimit;
- Ekzistenca e zonave të mbrojtura dhe buferike.

## **2. KUADRI LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL**

### **2.1 Kuadri Institucional për Mbrojtjen e Mjedisit**

Institucionet mjedisore në Shqipëri kanë kaluar nëpërmjet një procesi reformash të thella institucionale gjatë dy dekadave të fundit. Si rezultat i përpjekjeve disa vjeçare të të gjithë aktorëve të interesuar brenda vendit, si dhe kontributit të komunitetit ndërkombëtar, në Shtator 2001 u suprimua Agjencia Kombëtare e Mjedisit (nga 1991 deri 1998; Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit) dhe në vend të saj u krijua Ministria e Mjedisit e cila, në vazhdim të trendit për rritjen e autoritetit në mbrojtjen e mjedisit, në vitin 2005 transformohet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU), dhe sot Ministria e Mjedisit.

#### **2.1.1 Ministria e Mjedisit**

Ministria e Mjedisit, është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin e mjedisit dhe politikave mjedisore në nivel kombëtar në Shqipëri.

#### **2.1.2 Niveli Rajonal dhe Vendor**

Në nivel Prefekturë veprojnë 12 Agjensi Rajonale të Mjedisit (ARM), të cilat varen nga MM. ARM-t i kryejnë funksionet në bashkëpunim me Inspektoriatet Rajonale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Inspektoriatet Sanitar të Ministrisë së Shëndetësisë në rreth.

#### **2.1.3 Organizatat Jo-Qeveritare**

Organizatat mjedisore shqiptare u krijuan për herë të parë pas rënies së regjimit totalitar, kur demokracia krijoi kushtet e favorshme për formimin dhe zgjerimin e organizatave jo qeveritare (OJQ). Fillimisht, OJQ-të e para u formuan në Tiranë dhe anëtarët e tyre ishin të limituar në specialistë të fushave të lidhura me shkencat mjedisore: biologji, kimi, gjeografi. Tashmë në Shqipëri ka rreth 150 OJQ mjedisore, por vetëm një pjesë e tyre janë aktive.

## **2.2 Legjislacioni Mjedisor**

Zhvillimi i një sistemi ligjor modern për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri nisi në vitin 1991. Janë bërë shumë përpjekje për përmirësimin e sistemit ligjor mjedisor dhe janë përgatitur dhe miratuar mjaft akte të reja ligjore dhe nënligjore, kryesisht duke përafruar direktivat përkatëse për mjedisin të Bashkimit Evropian. Sistemi i sotëm ligjor është duke kaluar një proces të vazhdueshëm përmirësimi. Qeveria i përkushton kujdes të veçantë harmonizimit të ligjeve me ato të Bashkimit Evropian (BE).

### **2.2.1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit**

Parimet kryesore, të cilat rregullojnë legjislacionin mjedisor në Shqipëri, janë të njëjta me ato të Bashkimit Evropian. Ato janë të përcaktuara në ligjin e ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 10431, datë 9.6.2011, kapitulli II:

- Zhvillimi i qëndrueshëm;
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake;
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore;
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit;
- Parimi i përafrimit të integruar;
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit;
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit;
- Ndotësi paguan;
- Ndërgjegjësimi publikut dhe pjesëmarrja në vendimmarrje.

Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit, është pasuruar progresivisht me akte ligjore dhe nënligjore të cilat janë përgjithësisht përfaqsim me direktivat dhe standardet mjedisore të Bashkimit Evropian. Ndër to do të veçonim ligjet:

- "Për Mbrojtjen e Mjedisit";
- "Për Lejet e Mjedisit";
- "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis";
- "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve";
- "Për miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes"
- "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit";
- "Për Trajtimin e Ujrave të Ndotur";
- "Për Substancat dhe Preparatet Kimike";
- "Për Administrimin e Zhurmave në Mjedis";
- "Për Zonat e Mbrojtura";
- "Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja";
- "Për Taksën e Karbonit e të Ambalazhit Plastik";

Krahas hartimit të ligjeve, vitet e fundit, është punuar për plotësimin me akte nënligjore të ligjeve të miratuara, me qëllim që të lehtësohet zbatimi praktik i tyre:

- Vendimi "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë";
- Vendimi "Për normat e cilësisë së ajrit";
- Vendimi "Për normat e shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit";
- Vendimi "Për shpalljen e monumenteve të natyrës shqiptare";
- Vendimi "Për administrimin e zonave të mbrojtura";
- Vendimi "Për rregullat e miratimit të zonave të mbrojtura dhe buferike";
- Vendimi "Për ndalimin e menjëherëshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit të shtretërve të lumenjve"
- Vendimi "Për certifikimin e specialisteve për hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor";
- Vendimi "Për miratimin e strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit"
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».
- VKM nr. 686 datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".
- Ligji 12.2015 date 26.02.2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis".

### **2.2.2 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**

Ligji i VNM Nr. 10440, datë 07.07.2011, i cili ka përfaqësuar plotësisht me Direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian, është një nga aktet ligjore më të rëndësishme për parandalimin e ndotjes apo dëmtimit të mjedisit nga aktivitet humane. Ky ligj kërkon bërjen e një vlerësimi të përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis. Ligji përmban edhe listën e aktiviteteve, të cilat duhet t'i nënshtrohen (i) Procesit të thelluar të VNM, ose (ii) Procesit të përmbledhur të VNM. Gjithashtu një nen i veçantë i kushtohet pjesëmarrjes së publikut si pjesë e procesit të VNM, përfshirë edhe vendimarrjen. Publiku dhe OJF, në rastet e konstatimit të parregullsive në këtë proces, kanë të drejtën t'i kërkojnë MM, rishqyrtim të VNM.

### 2.2.3 Ligji për Planifikimin e Territorit

Ky akt ligjor me Nr. 10119, datë 23.4.2009, azhornuar në vitin 2010, ka për objekt përcaktimin e planeve bazë, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për planifikimin e territorit. Kërkesa për VSM për planet, ashtu si dhe në ligjet për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe atë të VSM, përshkruhet nominalisht në nenet 21, 47 dhe 48 të këtij ligji, madje neni i fundit i dedikohet tërësisht VSM, duke theksuar se ky vlerësim kryhet gjatë procesit të hartimit dhe para miratimit të instrumentit të planifikimit.

### PROFILI I PROPOZUESIT

Me përgatitjen e dokumentacionit perkates Bashkia Berat kerkon te pajiset me Vendim te VNM-se Paraprake sipas Ligji 12.2015 date 26.02.2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440 datë 7.7.2011" Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM nr. 686 datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

## 3. RAPORTI PARAPRAK I VNM-SE

### 3.a) Pershkrimi I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi.

Kjo zone perfaqsohet kryesisht nga shkurret mesdhetare dhe ai i dushkut. Shkurret me te perhapura jane marja, dellenja, shqopa, shkoza, mënishtja, xina etj. Nje pjese te mire perfasohet nga makja. Bimësia në këtë teren dominohet nga ato tipiket për këtë si dëllinja (*Juniperus* sp.), driza (*Paliurus aculeatus*), murrizi (*Crategus monogyna*) trëndafili i egër (*Rosa* sp.), ferra (*Rubus ulmifolius* Schott.).

Mbi këtë bazë numuri i tyre paraqitet shumë më i vogël se sa ai në pyjet e mirfillta në vendin tonë. Si më të shpeshtë këtu takohen thëllëza, shapka, mëllenja (*Turdus merula*), curla etj. Duhet theksuar se përhapja e kufizuar e llojeve është e kushtëzuar nga gjendja e pyjeve në këtë zonë e cila nuk favorizon një folenizim, ushqim dhe qëndrim të qetë dhe normal të shpendëve.

Në këtë territor shpesh takohen edhe trumcakët e kryeartëzat (*Gardelius gardelius*), kumritë etj. Po kështu në periudhën e verës takohet edhe trishtili. Shpendët e mëdhenj grabitqarë tashmë nuk takohen në këtë rajon. Bimësia drunore e lartë në formën e pyjeve të mirfilltë pothuajse mungon dhe dominohet nga llojet e sipërpërmendura dhe dushkajat që janë dëshmitarë të pranisë së tyre massive në të kaluarën. Fauna dallohet për praninë e elementëve që në nivel kombëtar paraqesin popullata në rritje si dhelpira (*Vulpes vulpes*) ose në ulje sic është ajo e lepurit (*Lepus capensis*).

Zona në studim, Nennjesia Strukturore C 2.2a/1 është nën administrimin e Bashkisë Berat. Nga pikëpamja funksionale, kjo zonë është klasifikuar si zonë e banuar. Terreni në të cilën shtrihet PDV-ja është kryesisht një terren fushor.

Shtrihet në pjesën lindore të qytetit dhe kufizohet nga:

- V.Verit: Aksi kryesor i rruges " Antipatrea "
- J.Jug: Nennjesitë R3.1b/1
- L.Lindje: Nennjesitë C2.2a/2
- P.Perëndim: Nennjesitë R2.3 b/3

Territori në fjalë nuk është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonë të mbrojtur si:

- a) rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (Kategoria I);
- b) park kombëtar (Kategoria II);
- c) monument natyror (Kategoria III);
- d) rezervat natyror i menaxhuar/ zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV);
- e) peisazh i mbrojtur (Kategoria V);
- f) zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara/zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë (Kategoria VI).



Territori në studim gjithashtu nuk është i përfshirë në zonë buferike të ndonjë zone të mbrojtur.  
Projekti i Planit të Detajuar Vendor për Nennjesinë Strukturore C 2.2a/1 , në bazë të Ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “ Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis “, Neni 5 “ Vlerësimi strategjik mjedisor “ ku thuhet:



### **3.b) Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqene kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij.**

Ujerrat nentokesore ne Shqiperi jane te pranishem ne shkembinj te ndryshem te koherave te ndryshme nga periudha paleozoike ne ate kuaternare. Eshte nje pasuri natyrore shume e rendesishme sepse eshte burimi kryesor per uje te pijshme. Ujerrat nentokesore u nenshtrohen faktoreve klimatike, morfologjike, hidrologjike dhe gjeografike.

Ujrat paraqesin nje burim te konsiderueshem per Shqiperine. Rrjeti lumor eshte shume kompleks, me nje siperfaqe te pellgut ujembledhes prej rreth  $4\ 3\ 305\ km^2$  ( $28\ 748\ km^2$  nga te cilet brenda territorit te Shqiperise). Te gjithete lumenjte shkarkojne ne Detin Adriatik dhe kane pergjithesisht drejtim Lindje-Perendim. Lumenjte kryesore jane Buna, Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa. Sasia e ujrave rrjedhese siperfaqesore ulet shume gjate muajve te veres. Vetem 6-9% te reshjeve vjetore jane verejtur gjate stines se thate (Korrik - Shtator). Lumenjte Shqiptare karakterizohen nga prurjet e medha. Prurja mesatare e pergjithshme eshte rreth  $1\ 308\ m^3/s$ , nderkohe qe prurjet maksimale jane shume me te larta. Prurjet mesatare transportojne  $53\ 250\ 000\ ton$  aluvione ne vit, e barabarte me  $1\ 650\ kg/s$ . Prurjet maksimale takohen gjate periudhes se lagesht te vitit dhe perfaqesojne 82 % te volumit vjetor

Lumi Osum, qe kalon ne qytetin e Beratit, buron nga malësia e Vithkuqit ne lartësinë 1050 m mbi nivelin e detit dhe përfundon ne fshatin Arëz 17.5 m mbi nivelin e detit ku bashkohet me Devollin për të formuar Semanin. Lumi pasqyron ne regjimin hidrologjik të tij, karakterin madhështor të klimës. Prurja maksimale dhe prurja minimale është regjistruar më 1979, me  $11.75\ m^3/sek$ .

Siç shihet, prurjet i arrijnë vlerat më të mëdha në shkurt dhe mars, dhe më të ultat në gusht dhe shtator.

Lumi Osum është tipik torrencial, me energji të madhe, aq sa e detyron lumin Devoll t'i nënshtrohet drejtimin të Osumit pas bashkimit me të.

Në gjendjen e sotme, lumi ka një shtrat shumë të deformuar, me kapacitet transportues të vogël, me shumë meandra, ndërsa në qytetin e Beratit, ai ka një shtrat të gjerë që vazhdimisht, me aluvionet e tij, e mbath duke e cekësuar atë. Lumi në qytetin e Beratit, shpesh karakterizohet nga vërshime dhe shkak për këtë bëhet përplasja e rrymave ujore në rrëzë të malit të Drobonokut, duke u kthyer në drejtim të qytetit. Përmbytjet ndodhin rrallë dhe e fundit ka ndodhur në nentor 1966, ku niveli i ujit në qytet arriti 1 m. Pilotat e lumit Osum lëkundën ndërmjet 1.2 - 1.8 m. Rrjedhja e ngurtë e lumit Osum ka ndryshuar nga 23210 ton në 11710 ton, duke pasur rrjedhjen mesatare vjetore 56310 ton, dhe me një turbullirë mesatare të seksionit  $4100\ gr/m^3$ . Muajt me rrjedhjen e ngurtë më të madhe janë: marsi, nentori, dhjetori, duke patur secili nga 20 % të rrjedhjes vjetore.

#### **Cilesia e Ujrave Nentokesore**

Cilesia e ujrave nentokesore te Zones se Beratit nuk eshte e kenaqshme. Shumica e puseve arteziane kane dhe ne uje, brenda kufijve te standarteve te ujit te pijshem. Uji eshte zakonisht i rende, permbajtjet e klorit dhe natriumit jane ne kufijte e pranueshmerise dhe perqendrimi i hekurit zakonisht kalon kufirin e standartit te ujit te pijshem prej  $0.2\ mg/l$ .

#### **Hidrologjia**

Sipas studimit te zones, ujrat nentokesore jane freatike me drejtim rrjedhjeje pergjithesisht juglindor. Thellesia e ujrave nentokesore, eshte percaktuar gjate rlevimeve fushore. Parametrat kimike dhe fizike te ujrave nentokesore jane matur ne cdo pus gjate pastrimit.

#### **Cilesia e Dheut dhe Ujit Nentokesor**

Gjate studimit te kryer ne zone nuk jane verejtur shenjat e dukshme te ndotjes. Nuk eshte vene re asnje mbushje ne asnjeren prej 78 gropave dhe nuk jane verejtur material te ndotura ne siperfaqen e tokes. Studimet fushore zbuluan prezencen e ujit te paster ne te gjitha fazat e pastrimit.

**3.c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative , ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer.**

Në këtë pjesë paraqiten ndikimet që konsiderohen të rëndësishme gjatë fazave të ndryshme të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Ato do të klasifikohen të drejtpërdrejta, siç është erozioni i tokës gjatë ndërtimit dhe zhurmat e punimeve, prishja e strukturave të tokës, ose indirekte, si ndryshimet në përdorimin e hapësirave të planifikuara të tokës dhe zhvillimit ekonomik.

Në raport me kohëzgjatjen e efektit të tyre, ato janë afatshkurtra dhe afatgjata.

*Fushat e ndikimeve*

Në Planin e Detajuar Vendor jepet lista e ndikimeve potenciale, të cilat eventualisht do të shoqërojnë aplikimin e këtij plani në tërësi përgjatë gjithë fazave të tij. Sipas natyrës së tyre, këto ndikime mund të renditen:

- Ndikimet që janë të pamunduara të ndodhin, sepse natyra dhe fusha e Planit të Detajuar vendor dhe modelet e tij mjedisore janë të tillë që faktorët përgjegjës për shkaktimin e ndikimit në mjedis mungojne/kanë magnitudë të neglizhueshme, ose receptoret e ndjeshmërisë nuk ekzistojnë;
- Ndikimet përfituese ose keqësuese të nëndara brenda tyre, që kanë rëndësi të moderuar ose të lartë dhe kanë ndikim në performancën mjedisore të njësive dhe nënjësive strukturore të Planit të Përgjithshëm Rregullues;
- Përgjithësisht, ndikime relative keqësuese të vogla që duhet të zbuten, në interes të përmirësimit të performancës mjedisore.

Komentet e shkurtra për çdo ndikim dhe për çdo njësi dhe nënjësi strukturore të planifikimit hapësinor të qytetit të Beratit, tregojnë arsyen për kalim në një kategori të veçantë të zonave të përcaktuara në P.P.V. Duhet të vemë në dukje që vlerësimi i ndikimeve tregon marrëdhënie të nivelit potencial të ndikimit, duke marrë parasysh se asnjë masë zbutëse e ndikimit, nuk adoptohet për rritjen e përfitimit ose të keqësimit.

*Ndikime që shoqërojnë transportimin e materialeve të ndërtimit*

Transportimi i një sasive relativisht të madhe të materialeve të ndërtimit në pika të ndryshme të qytetit, është përbërës i rëndësishëm i veprimtarisë ndërtimore. Trafiku transportues jo vetëm rrit dukshëm volumin total të trafikut ditor në rrugët ekzistuese, por do të rritë në mënyrë të konsiderueshme numrin e makinave të rënda. Këta faktorë do të çonin në një rritje të rëndimit ose bllokimit në trafik. Rëndimi në rritje në kohën e pikut të trafikut herët në mëngjes dhe vonë pas drake mund të shqetësojë përdoruesit e tjerë të rrugës dhe gjithashtu çon në rritjen e aksidenteve në saj të frustrimit që krijohet nga lëvizja e ngadaltë e makinave të rënda. Makinat me ngarkesë bosh në kthim që tentojnë të lëvizin shumë shpejt, do të kontribuojnë në rritjen e rrezikut për përdoruesit e rrugës.

*Ndikimet që shoqërojnë gërmimet e dheut*

Në Planin e Detajuar Vendor nuk parashikohen raste ku punimet me dherat të rrezikojnë rrëshqitje të shpateve, për të cilat nga ana e eksperteve gjeoteknikë do të kërkohej rregullimi përkatës për gjeometrinë natyrore të shpateve.

*Humbja e drurëve në anë të rrugëve*

Nevoja për zgjerimin e rrugëve ekzistuese do të çonte në mënyrë të pashmangshme në humbjen e drurëve anës rrugëve në disa vende. Numri që do të duhej të vlerësohej, do të ishte relativisht i vogël. Vetëm një numër i pakët drurësh të mëdhenj ka gjasë të preken. Spastrimi i drurëve (pyjorë ose frutorë) mund të ketë një ndikim mbi pronarët në terma të humbjes së një vlere, që mund të kontribuojë në të ardhura ose mjete jetese dhe në banorët lokalë dhe përdoruesit e rrugëve në përgjithësi, humbjen e një tipari, që përmirëson paraqitjen estetike tëmrrugëve.

Nga pikëpamja faktike këta pak drurë relativisht të prekur, ndikimin e kanë të ulët.

Megjithatë, një numër shumë i madh shkurresh përgjatë anës së rrugëve do të hiqen. Në këtë rast është parashikuar që mbjellja e drurëve dhe bordurave të gjelbëra do të ishte fitimprurëse dhe do të caktohet në kontratën ndërtimore.

#### *Ndikime mjedisore, humane dhe shoqërore*

##### *Mjedisi natyror*

- Pritet një keqësim i cilësisë së ajrit si pasojë e pluhurit dhe tymit në vendndërtime, në hapësirat e parashikuara për ndërhyrje urbane, rrugëve që do të ndërtohen të reja sipas P.D.V ose do të rikonstruktohen, rrugëve të pasistemuara ose të pashtruara në fazën e parë të zbatimit të P.D.V dhe impianteve të ndërtimit dhe ato të asfaltimit që ndodhen brenda qytetit dhe kanë ndikim direkt në jetën e qytetarëve.
- Rritje e nivelit të zhurmave që krijohen prej aktivitetit ndërtimor dhe që janë te pranishme gjatë gjithë fazës së zbatimit të P.D.V;
- Gjenerimi dhe eliminimi i papërshtatshëm i mbetjeve ndërtimore;
- Përdorimi i mjediseve dhe sipërfaqeve të papërshtatshme për depozitim dhe përpunimin e materialeve që përdoren për ndërtime, me pasojë dëmtimin e mjedisit natyror (prerje pemësh, ndërhyrje në sipërfaqet e gjelbëruara, etj);
- Erozioni i tokës që vjen nga ndërhyrjet në hapësirat ndërtimore të planifikuara duke shkaktuar rritje të turbiditetit të ujit në rrjedhat ujore;
- Kontaminimi i ujrave sipërfaqësore me mbetje ndërtimore gjatë prishjes së ndërtimeve të vjetra si pasojë e mungesës së mundësive për ripërdorim dhe riciklim;
- Kontaminimi i ujrave sipërfaqësore me lëndë të rrezikshme, si asfalte dhe bitume gjatë ndërtimit të rrugëve;
- Pakësimi i sipërfaqeve të gjelbëra në rastet kur plani parashikon zgjerim të rrugëve ose ndërtimin e tyre në zona me gjelbërim;
- Humbja e disa drurëve frutore dhe kopshteve me perime në njësitë dhe nënjësitë strukturore që janë parashikuar me ndërtime urbane dhe rrugë.

Shumica e ndikimeve të paraqitura më sipër kanë natyrë të përkohshme, por disa prej tyre do të kenë ndikim negativ dhe afatgjatë dhe do të shoqërojnë gjithë kohën e zbatimit të P.D.V. Masa zbutëse të përshtatshme janë paraqitur më tej në këtë raport, për cdo njësi dhe nënjësi strukturore të planifikuara në studimin hapësinor të qytetit të Beratit. Shumë nga ndërtimet do të kryhen në vendet e ish-godinave të vjetra kështu që dëmtimet në hapësire dhe në tokë nuk do të jenë të mëdha. Ndikim kryesor kanë prerja e drurëve dhe bimësisë anës rrugëve për zgjerimin e tyre si pasojë e nevojës së një periudhe disa vjeçare për ripërtëritjen e tyre.

##### *Mjedisi human*

Ndikimi Planit të Detajuar Vendor mbi mjedisin human përfshin:

- *Shpronësimi dhe përdorimi i tokës*

Krijimi i shesheve për ndërtime, si dhe zgjerimet e rrugëve kërkojnë edhe shpronësimin e tokës së planifikuara nga P.D.V. Në rastin konkret nuk do të kemi shpronësime pasi nuk kemi të bëjmë me pronësi të shtetit por me pronësi private.

Lidhur me përdorimin e tokës, siç u tha edhe më lart, pjesa më e madhe e saj në nënjësinë strukturore C 2.2 a/1, është në pronësi të privatit, si rrjedhojë nuk priten probleme madhore në lidhje me shpronësimin.

- *Ndikimet mbi monumentet e kulturës*

Në Planin e Detajuar Vendor nuk ka raste që ndërtimet mund të kryhen afër monumenteve të kulturës, si kisha, xhamia e qytetit, objekte që janë shpallur monumente kulture, etj. Edhe objektet arkeologjike, që

mund të rezultojnë gjatë gjurmëve për ndërtimin e objekteve të reja, do të mbrohen dhe do të ruhen të paprekur duke krijuar kushte për konservimin e trajtimin sa më të mirë të tyre në të ardhmen.

• *Ndikimet të përkohshme*

Mjedisi lokal dhe banorët përreth do të ekspozohen ndaj pluhurave, tymrave dhe mbetjeve ndërtimore që do të krijohen nga punimet e zbatimit të P.D.V. Si pasojë e makinave të rënda që do të përdoren për ndërtime dhe rikonstruksionin e objekteve ekzistuese, është e pritshme një rritje e sasisë së emetuar të tymrave dhe gazrave, e cila do të jetë më e madhe në periudhën e verës, për vetë volumin më të madh të punimeve që kryhen në këtë stinë. Trafiku i tepruar gjatë kësaj periudhe do të jetë mjaft shqetësues në krijimin e pluhurave dhe ekspozimi i banorëve ndaj zhurmave mbi nivelet e lejuara nga makineritë e rënda do të krijojë stres nervor, i dëmshëm për shëndetin e tyre.

*Ndikimet që shoqërojnë zbatimin e planit të përgjithshëm vendor*

*Mjedisi Natyror*

Zbatimi i Planit të Detajuar Vendor do të rezultojë me shkarkimin e ndotësve, si vajrat dhe metalet e rënda që do të depërtojnë në tokë si pasojë e shplarjes së rrugëve nga ujrat atmosferike. Kjo do të shkaktohet me rritjen e nivelit të trafikut si rezultat i ndërtimeve dhe përmirësimit të rrugëve.

Pritet që shkarkimet e substancave helmuese të ulen me rritjen e shpejtësisë dhe në saj të cilësisë më të mirë të karburanteve. Sidoqoftë, shkarkimet mundet gjithashtu të shtohen për shkak të konsumit të lartë të lëndëve djegëse, që i korrespondojnë shpejtësisë së lartë të makinerive. Një rritje e ndotjes së ajrit, në një farë shkalle, do të kompensohet me përmirësimin e teknologjisë për kontrollin e shkarkimeve nga makineritë e importuara.

Me përmirësimin e rrugëve, niveli i zhurmave do të ulet. Aktualisht, automjetet shpesh ulin shpejtësinë, pastaj e rrisin, për të mënjeluar ose për të kapercyer segmente të dobëta të rrugëve. Nuk dihet nëse ka lloje faunistike të rrezikuara (gjitarë, shpendë, amfibë, etj.) në hapësirat ndërtimore.

Më poshtë, jepen ndotjet kryesore si rezultat i shkarkimit në mjedis:

- Shkarkimi i tymrave nga motorët diesel (përfshirë pjesëzat e hidrokarbureve aromatike policiklike të absorbueshme);
- Trafiku në rritje do të shkaktojë më shumë shkarkime plumbi, si pasojë e përdorimit të benzines me plumb)
- Shtimi i shkarkimeve të CO, CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, pjesëzave, metaleve të rënda dhe aerosoleve si pasojë e rritjes së dendësisë së trafikut;
- Gjenerimi i filmit të naftës në sipërfaqe të rrugëve dhe depërtimi i naftës dhe ndotësve të tjere në tokë
- Kontaminimi i rrjedhave ujore me film HC dhe pluhur të kontaminuar;
- Kontaminimi i ujrave nëntokësore me HC, pluhur të kontaminuar, etj.

*Analiza e Plotë e Ndikimit në Mjedis*

Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor të projektit, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky plan projekt. Tabela e mëposhteme shërben si një check-list e kriterëve mjedisorë sipas të cilave është bërë vlerësimi i këtij projekti. Kjo listë tregon nëse projekti e ka marrë në konsideratë problemin, e po të jetë kështu, nëse i ka dhënë përgjigje.

Ndikimi i problemeve mjedisorë nuk është perkthyer ende në efekte ekonomike apo shëndetësore. Për këtë arsye, është e vështirë që të matet saktësisht nga pikepamja sasiore shkalla e ndikimit që do të ketë projekti mbi mjedisin apo shëndetin. Megjithatë, prirjet e këtij ndikimi janë të parashikueshme. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimit të mundshëm mjedisor, fillimisht është e nevojshme të përcaktohen të gjithë faktorët të cilët mund të ndikohen nga ky projekt.

Kriteri	marre parasysh ne projekt	Analiza mjedisore dhe perputhja me projektin
1. Demografia		
a. Skenaret e rritjes se popullsise	Po	I konsideruar ne PRrT ne percaktimin e zonave per perditimin urban dhe percaktimi i kateve. Kjo integrohet edhe me infrastrukturen e re rrugore qe propozon projekti.
2. Perdorimi i Tokes		
a. Planifikimi Urban dhe Drejtimi i Zhvillimit	Po	Ne perputhje me PRrT per perdorimin e tokes dhe tipet e nderhyrjes.
i. Kapacitetet mjedisore ne zonat e propozuara per zhvillim	Po	Zona gjendet ne gjendje fushe, aplikimi i projektit per kete zone do te percaktoje edhe hapsirat publike.
Zhvillimi i hapësirave të gjelbërta	Po	Projekti parashikon hapsira të gjelbërta përreth objekteve
ii. Sherbimet dhe lehtesirat Publike	Jo	Nuk jep te dhena.
iii. Forma urbane dhe dendësia	Po	Projekti percakton kriteret e ndertimit dhe vendosjen e objekteve. Percakton kriteret e perdorimit, hapësirat publike, parkingun.
b. Mbrojtja e detajuar e Zonave të Gjelbra		
i. Lumenjte	Jo	Nuk ka ndikim
ii. Parqet	Jo	Nuk ka ndikim
iii. Pjesa e brendshme e nennjesise	Po	Nuk jepen te dhena
3. Fatkeqesite e natvres		
a. Rreshqitjet e tokes	Jo	Nuk verehen rreshqitje te tokes. Zone e stabilizuar e rrafshet.
b. Permbytjet	Jo	Nuk permendet si do te trajtohen rastet e permbytjeve.
c. Termetet	Po	Lartesia e kateve dhe konstruksionet do te kryhen ne perputhje me rregullat dhe legjislacionin ne fuqi.
4. Sherbimet eInfrastruktures		
a. Furnizimi me Uje	Po	Propozimi i ndertimeve te reja sjell edhe lidhjen me sistemin e furnizimit me uje.
b. Kanalizimet e ujerave te zeza dhe trajtimi ityre	Jo	Presupozohet se do te lidhet ne sistemin e kanalizirneve te ujerave te zeza te zones.
c. Menaxhimi i Mbetjeve te Ngurta	Po	Grumbullimi do te kryhet sic eshte kryer deri me tani nga shoqerite e specializuara te kontraktuara nga bashkia Berat
d. Energjia & Telekomunikacioni	Po	Do kryhen lidhjet perkatese te energjise dhe sistemeve te komunikimit.
e. Energjia (efikasiteti dhe energjia e rinovueshme)	Jo	Jo. Mund te bente sugjerime per projekte ndertimi me eficiente nga pikeparnja e konstruksioneve qe kursejne energjine.
Cilesia e Ajrit	po	Do te kete nje perkeqesim te cilesise se ajrit ne zone vetem gjate kohes se ndertimit te objekteve te reja. Me mbarimin e punimeve cilesia e ajrit do te permiresohet ndjeshem pasi nuk do te kete me pluhur qe ngrihet ne atmosfer nga kantieri i ndertimit.
Cilesia e Ujerave Siperfaqesore	po	Do kete nje ndikim elementar vetem gjate fazes ndertimore. Me mbarimin e punimeve ujerat siperfaqesore do te organizohen ne nje sistem qendror.
Cilesia e ujerave nentokesore	po	Rekomandon mbylljen e rezervuareve te furnizimit me uje per Bashkine. Kjo do te kerkonte zevendesimin me nje burim tjetër i cili duhet ndertuar dhe dhene per administrim.

5. Strehimi		
a. Zonat	Po	Vetem siperfaqja e prones parashikohet te jepet per ndertime. Zona me ndertesa polifunkionale mund te lejoje vetem shtese kati, dhe sistemim te hapsirave te lira per mjedise shlodhese / argetuese.
b. Dendesite	Po	Dendesi e ndryshueshme per t'iu pershtatur llojeve te ndertimit dhe te tokes. Rritja e dendesise ben te mundur perdorimin me efikas te tokes dhe parandalon shtrirjen e parregullt urbane.
c. Cilesia	Po	Sheshit aktuale eshte i lire dhe nuk parashikohen per prishje dhe konsiderohen relativisht ne gjendje te mire sipas projektit
d. Shkalla sizmike	Po	Rekomandon kriteret projektimi ne perputhje me nivelin 8 ne shkallen MSK-647, pasi ky eshte nje rrezik i njohur. Do te ishte mire te sugjeroheshin projekte sipas Shkalles Evropiane Makrosizmike (EMS) per te respektuar standardet Evropiane.
e. Ruajtja dhe Trashegimia	Po	Nuk ka zona te rendesishme per trashgimin kulturore ne kete zone.
6. Rruget dhe Transporti		
a. Propozime per rruge	Po	Nuk propozohen rruge qe rrethojne zonen
b. Qarkullimi i trafikut	Po	Gjendja aktuale e trafikut dhe levizjes se mjeteve ne kete zone eshte disi e sistemuar. Do te kete nje perkeqesim te trafikut ne zone vetem gjate kohes se ndertimit te objektit nga levizja e kamioneve dhe aktiviteti i kantierit.
c. Parkimi	Po	Propozim i projektit nuk parashikon nje parking nentokesor ku do te ndertohet objekti. Parkimi do te jete ne siperfaqe.
d. Siguria ne rruge	Po	Nuk do te kete me dalje ne rrugen kryesore nga shume tipe rrugesh aksesu sic behet tashme.
e. Transporti publik	Po	nuk ka transporti publik.
7. Cilesia e Ajrit	Po	Do te kete nje perkeqesim te cilesise se ajrit ne zone vetem gjate kohes se ndertimit te objektit te ri .Me mbarimin e punimeve cilesia e ajrit do te permiresohet ndjeshem pasi nuk do te kete me pluhur qe ngrihet ne atmosfer nga kantieri i ndertimit.
8. Cilesia e Ujerave Siperfaqesore	Po	Do kete nje ndikim elementar vetem gjate fazes ndertimore. Me mbarimin e punimeve ujerat siperfaqesore do te organizohen ne nje sistem qendror.
9. Cilesia e ujerave nentokesore	Po	Rekomandon mbylljen e rezervuareve te furnizimit me uje per Bashkine.
10. Konsiderata per ekologjine dhe biodiversitetin	Pjeserisht	Zona ka karakter rural dhe nuk perben nje ekosistem natyror te zhvilluar, Propozimi i projektit do te shtoje siperfaqet e gjelberta ne zone.

Bazuar në analizën e mësipërme ky seksion bën rekomandime të mëtejshme. Kriteret që janë shënuar me **Po** nuk diskutohen më tej, pasi nuk konsiderohen si problematikë.

Tabela e mesiperme përmban një përmbledhje të të gjitha problemeve mjedisore dhe shkallën në të cilën projekti u jep përgjigje secilit prej tyre.

#### *Ndikimet akumulative*

Nderhyrjet qe do te kryhen ne zone do te kene edhe ndikime qe mbivendosen me aktivite te ndryshme ndertimore brenda dhe jashte kesaj zone, p.sh mund te konsiderohet si ndikim akumulativ shkaktimi i ndotjes akustike nga aktiviteti ndertimor, e cila bashkohet edhe me aktivitetin urban te zones se kesaj zone dhe jo vetem. I njejt arsyetim mund te kryhet edhe per emisionet ne ajer te aktivitetit ndertimor qe bashkohen me emisione te tjera qe nuk i perkasin kesaj zone.

Pika kryesore qe do te shkaktohet me teper ndikim, si ne pikpamjen e zhurmes ashtu edhe ne ate te shkarkimeve ne ajer, eshte ne zonen ku parashikohet te ndertohet objekti banimit.

Nevojitet qe investitori te ndermarre masa konkrete per minimizimin e impakteve si psh ngritja e pluhurit duke e mbajtur sheshin e punes te lagura vazhdimisht, kontrollin periodik te mjeteve per sasine e zhurmes dhe gazeve qe shkaktojne nga gjendja e tyre teknike etj.

#### *Emisionet nga trafiku i automjeteve*

Duke qene se zona ne studim eshte nje zone e pak populluar dhe ka një trafik te automjeteve te pa konsiderueshem dhe emisionet nga mjetet levizese shkaktojne ndotje te atmosferes se zones te pallogaritshme, sasia e emetuar e gazeve nga mjetet levizese te kantierit duhet konsideruar si ndikim kumulativ dhe jo i vecuar.

Ne lidhje me trafikun rrugor qe do te krijohet nga aktiviteti ndertues, duhet theksuar se e gjithë zona do te kete nje ndikim nga trafiku i kamioneve dhe autobetonierave gjate 8 oreve te punes. Kjo mund te shkaktoje veshtiresi ne qarkullimin rrugor, sidomos gjate oreve ku ky segment rrugor perdoret me shume. Rekomandohet qe per lehtesimin e trafikut te perdoren punonjes te shoqerise qe te drejtojne daljen e kamioneve ne rrugen kryesore.

#### *Ndotja e tokes*

Ne zonen e planifikuar per zhvillim, ku planifikohet te kryhet ndertim i ri, ka nje siperfaqe te lire ekzistuese. Nga informacioni i mbledhur kjo siperfaqe nuk eshte perdorur per zhvillimin e ndonje aktiviteti prodhues. Duke qene se ne kete siperfaqe nuk ka patur ndonje aktivitet te meparshem nuk vleresohet me vend te kryhen analiza fiziko-kimike te cilesise se tokes perpara ndertimit te ndertesave te reja. Ne kete rast investitori nuk nevojitet te kryej keto analiza te tokes dhe te bashkengjise rezultatet ne kete raport, per nje vleresim te metejshem te autoriteteve qe do leshojne lejen mjedisore.

#### *Ndikimet ne biodiversitet*

Zona ne studim karakterizohet nga nje bujqesi e kultivuar gjeresisht ne te gjithë siperfaqet e mundshme. Ne shumicen e rasteve gjenden bimesi natyrore ose gjysme natyrore. Pjesa me e madhe e zones se studimit I perkasin kryesisht tokes mocalore te kripur, e cila i dedikohet bujqesise, keshtu qe ajo nuk paraqet habitate te vecanta natyrore. Zona ne studim mbulohet nga shkurre dhe peme te shperndara. Ne kete zone gjenden edhe speciet e flores se ligatinave, zogjte, amfibet dhe reptile. Tokat me bar gjysem natyror jane formuar si rezultat I efekteve te kombinuara te proceseve natyrore dhe aktiviteve antropogjenike.

Proceset per kthimin e tokes bujqesore ne truall ndertimi tregojne per nje influence te dobet ne shumellojshmerine e specieve. Brenda zones ne studim identifikohet toka me barerat te keqija dhe me te njejtat lloje te tokes me bar gjysem natyror ku dominohet kryesisht nga *Ditrichia viscosa* etj.

### ***3.ç) Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si : ujera te ndotura, gaze, pluhur, zhurma, vibrime, si dhe prodhimin e mbetjeve.***

*Informacion i detajuar per shkarkimet nga burimet e identifikueshme te ndotjes ne ajer*  
Do te kete nje perkeqesim te cilesise se ajrit ne zone vetem gjate kohes se ndertimit te objektit te ri. Me mbarimin e punimeve cilesia e ajrit do te permiresohet ndjeshem pasi nuk do te kete me pluhur qe ngrihet ne atmosfer nga kantieri i ndertimit.

#### *Shkarkimet e mundshme dhe fluruese*

Do te kete nje perkeqesim te cilesise se ajrit ne zone vetem gjate kohes se ndertimit te objektit te ri. Me mbarimin e punimeve cilesia e ajrit do te permiresohet ndjeshem pasi nuk do te kete me pluhur qe ngrihet ne atmosfer nga kantieri i ndertimit.

#### *Shkarkimet ne ujerat siperfaqesore*

Ne zonen ku do te ndertohe Godina banimi dhe sherbimi nuk eshte vene re prezenca e ndonje pellgu ujmbledhës.

Procesi i zbatimit te projektit nuk le shkas per ndotje te ujrave rrjedhese siperfaqesore qofte edhe indirekt (ne toke e me pas te shpelahen nga rreshjet) nga karburantet, lendet helmuese, etj pasi ato nuk do te perdoren



gjate zbatimit të projektit apo rehabilitimit të territorit, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

#### *Shkarkimet në tokë*

Përsa i përket ndotjes së tokës ajo mund të jetë aksidentale nga derdhja e karburanteve që përdorin makinat dhe mjetet e transportit.

Ndikimet më të mundshme mbi tokën kanë lidhje:

- Karakteristikat e tokës;
- Morfologjia e tokës;
- Ndotje

Gjate periudhës së shfrytëzimit në objekt është ndjekur një radhë dhe drejtimi i tillë i shfrytëzimit, që në kombinim me masat e tjera suplementare parandalojnë erozionin, shembjen dhe cedimet e sipërfaqes së tokës rreth saj.

#### *Ndotja e tokës nga rrjedhjet.*

Objekti është në fazë projektimi dhe gjate ndërtimit të saj niveli i elementeve që transmetohen nga rreshjet e shiut është në nivel të moderuar. Ky fenomen bëhet aktiv në rastet kur në qiell të hapur ndodhen pjesë mekanike të automjeteve apo ambalazhe të vajrave lubrifikant apo grasove këto shpëlahen nga rreshjet e shiut duke u shkarkuar në tokë.

#### *Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta.*

Sasia e sterileve do të depozitohen në sipërfaqen e caktuar për këtë qëllim. Ato përfaqësohen nga masa të shkruara, që nuk përmbajnë elemente ndotëse për mjedisin. Këto depozitime janë pjellore dhe do të shërbejnë me së miri për tu përdorur si material për mbushjen e hapsirave të shfrytëzuara ose për rehabilitim të territoreve të gërmuara.

#### *Ndotja e tokës nga depozitimi i llumrave.*

Gjate shfrytëzimit të objektit parashikohet depozitime llumrash që mund të kenë ndikim mbi ujrat e rrjedhshëm. Ky fenomen haset gjate prezencës së shirave të cilët shpëllajnë materialin e nxerre nga toka në fazën e germimit, por ky nuk konsiderohet ndotës për token pasi është element i nxjerr nga toka. Vlerësimi i erozionit të tokës duke marrë në konsideratë gjendjen ekzistuese të ekuilibrit të tokës ku ndër elementet më të rëndësishme mund të përmendim teksturën e tokës, aftësinë e infiltrimit (karakteristikat e shkëmbit), pjerresia, përmbajtja e gureve dhe faktorëve klimatik. Mendohet se ekuilibri aktual i tokës do të prishet në mënyrë rrenjesore gjate zbatimit të projektit, duke rritur sidomos aktivitetin aerodinamik të shkaktuar nga era mbi materialin e imet të grumbulluar në shesh.

#### *Shkarkimet e zhurmës dhe vibrimit*

##### *Zhurmat dhe dridhjet*

Burimet kryesore të gjenerimit të zhurmave dhe vibrimeve janë:

- Përdorimi i makinerive gjate fazës së ndërtimit
- Ngarkimi dhe shkarkimi i kamjoneve me material ndërtimi
- Ngarkimi dhe shkarkimi i kamjonve me konstruksione metalike të gatshme.

Duke u njohur me llojin e veprimtarisë kuptojmë se emetimi i zhurmave dhe vibrimeve në terren është i pranishëm. Përdorimi i makinerive gjate fazës së ndërtimit është proces pune i cili gjeneron zhurmë dhe vibrime të cilat vlerësohen në baze të sasive së tyre dhe janë të matshme.

Perdorimi i makinerive te transportit te lendeve te para si konstrukionet metalike, sandwicet dhe te betonit per bazamentin e magazines eshte proces pune i cili gjeneron zhurma dhe vibrime te cilat vleresohen ne baze te sasise se tyre dhe jane te matshme.

Zhurmat jane shkaku kryesor i keqesimit te jeteses ne qytete. Komunitetet ndahen ne zona me rrezik te madh prej zhurmes (zonat e zeza), dhe zonat me nivel te caktuar kujdesi (zonat gri).

Zhurma konsiderohet "tingull i padeshiruar" ose si "nje ndjesi degjimore e padeshiruar apo e bezdisshme". Zhurma ne fakt, nga pikpamja fizike ka karakteristika qe shpesh identifikohen me tingulin. Tinguli eshte perkufizuar si nje luhate e trysnise brenda nje mjete qe veshi njerezor arrin ta kape. Numri i luhateve te presionit sipas rastit, quhet frekuece e tingulit dhe matet me Hertz (Hz). Intensiteti i tingullit te perceptuar ne piken e matjes, qe perkon fizikisht me gjeresine e vales se trysnise, shprehet ne decibel me nivelin e trysnise zanore (Lp). Tingu qe veshi njerezor eshte i afte te perceptoje jane ata qe gjenden brenda te ashtuquajtures "banda e degjueshmerise", e karakterizuar nga frekuenca te perfshira nga 16 Hz e deri 16000 Hz dhe nga nivele me trusni zanore rreth 130 dB. Ne figuren me poshte tregohet banda e degjueshmerise, e kufizuar lart nga "pragu i dhembjes" dhe poshte me "pragu i degjueshmerise". Kjo kurbe e fundit spostohet lart me avancimin e moshes se nje individi. Ky fenomen i njohur si "Presbiacusia" prodhon nje humbje te aftesise degjimore, vecanerisht te frekuencave e te larta te tushes se degjimit.

Lufta kunder zhurmes mund te kryhet nepermjet tre nderhyrjeve te mundshme:

- Duke vepruar mbi burimet e zhurmes (duke pakesuar shperhapjen nga burimi ose duke permiresuar kushtet e levizshmerise brenda nje territori te caktuar);
- Duke vepruar ne shumimin e zhurmes (duke larguar sa me shume zonat e banimit nga zonat me ndotje te madhe akustike);
- Duke adoptuar sisteme mbrojtjeje pasive (barrier kunder zhurmes) ne ambientet me shume te ekspozuar nga shperndarja e zhurmes.

#### *Rezatimi jo-jonizues*

Pajisjet dhe proceset e punes qe kryhen ne ndertim nuk krijojne burime te rrezatimit jo- jonizues.

#### *Menaxhimi i mbetjeve te ngurta*

Administrata dhe punonjesit e kantierit do t'i kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga dispersiteti i mbetjeve te ngurta urbane, mbetjet ndertimore etj. Ne mjediset e kantierit duhet te vendosen kazane te grumbullimit te mbetjeve urbane te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet qe mund te riciklohen duhet te grupohen ne menyre te diferencuar per t'i marre ricikluesi me pas. Mbetjet e tjera shoqeria i depoziton ne vendgrumbullimin e mbetjeve te zones.

Per sa i takon mbetjeve ndertimore ato duhet te menaxhohen ne bashkepunim me Bashkine e Beratit.

#### *Menaxhimi i mbetjeve te lengeta*

Ujerat siperfaqesore te sheshit te punes duhet te orientohen ne sistem kanalizimesh dhe te derdhen ne sistemin e ujerave te zeza te sisitemit. Ujerat e zeza te gjeneruara nga kantieret e aktivitetit ndertimor duhet te terhiqen nga shoqeri te specializuara per kete pune.

#### *Menaxhimi i shkarkimeve te gazta*

Duhet te kontrollohen ne menyre periodike gjendja e mjeteve te renda te transportit dhe te shkarkimeve te tyre. Nese shkarkimet e tyre nuk jane brenda normave do t'i nenshtrohen rregullimit ne servis.

*Masat per minimizimin e ndikimit ne trafikun e zones*

Gjate punimeve si per ndertimin e objektit te ri ashtu edhe ne nderhyrjet e infrastruktures rrugore te zones shoqeria qe kryen punimet nevojitet te marr persiper qe te organizoje levizjen e mjeteve te transportit ne menyre te tille qe te mos shkaktoje rendim ne trafikun e zones.

*Mbjellja e siperfaqes se rezervuar per gjelberim (Rivegjetacioni)*

Ne te gjitha rastet kur verehet:

- prerje te drureve ne vendin e ndertimit,
- hedhje te dheut ne anet e prones,
- gerryrje te mundshme.

Kompania e kontraktuar detyrohet qe te realizoje mbjellje te bimeve dhe ne rastin e dherave te kryeje sheshimet e duhura dhe mbjelljen e tyre me bimesi lokale. Kjo gje do te ndihmonte ndjeshem ne eliminimin e demtimeve dhe rehabilitimin e peisazhit.

*Menaxhimi i hidrokarbureve ne kantier*

Veprimtaria e ndertimit bazohet ne perdorimin e mjeteve qe punojne me motore me djegie te brendshme, qe natyrisht kane nevojte edhe per lubrifikante. Ne kete rast rekomandojme:

1. Ndonese ne projekt nuk behet fjale per ndonje depo karburanti ose lubrifikanti brenda territorit te kantierit, ne te ardhmen dhe gjate gjitha veprimtarise se ndertimit ne asnje rast dhe per asnje arsye nuk duhet te ndertohej depo karburanti ose lubrifikanti.
2. Per te menjanuar ne maksimum riskun e rrjedhjeve aksidentale te karburantit e te lubrifikanteve:
  - Investitori nuk duhet te lejoje te perdoren makineri te vjeteruara apo te demtuara.
  - Mjetet motorike duhet te furnizohen me karburant e lubrifikant jashte territorit te kantierit.
  - Personeli perkates te udhezohet e te pajiset me mjetet e duhura, ne menyre qe edhe ne rast avarish aksidentale te automjeteve qe shoqerohen me rrjedhje te karburantit e te lubrifikantit, te jete ne gjendje t'i menjanojne ato shpejt dhe pa pasoja.

***3.d) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara.***

Kohezgjatja e ndikimeve negative ne mjedis do te jete gjate gjitha periudhes se zbatimit te projektit.

Ne perfundim mund te themi se implementimi i ketij projekti do te kete ndikim te drejtperdrejte ne mjedisin e zones, por ky ndikim do te jete vetem gjate fazes se ndertimit dhe nuk do te akumulohet ne mjedisin perreth. Ndikimi ne mjedis nga realizimi i ketij projekti do te jete i perkohshem dhe ne nivele te uleta dhe pas perfundimit te projektit do te kemi nje peizazh me te rregullt dhe me te paster.

Investitori do te jete i gatshem te bashkepusoje me institucionet pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit ne kuader te ruajtjes se cilesise mjedisore te zones.


3.dh) Te dhena per shtirjen e mundshme hapsinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.

Zona në studim, Nennjesia Strukturore C 2.2a/1 është nën administrimin e Bashkisë Berat. Nga pikëpamja funksionale, kjo zonë është klasifikuar si zonë e banuar.

Terreni në të cilën shtrihet PDV-ja është kryesisht një terren fushor .

Shtrihet në pjesën lindore të qytetit dhe kufizohet nga:

- V.Verri : Aksi kryesor i rruges “ Antipatrea “
- J.Jug : Nennjesitë R3.1b/1
- L.Lindje: Nennjesitë C2.2a/2
- P.Perëndim: Nennjesitë R2.3 b/3



Per shkak te vendndodhjes se tij projekti nuk ka ndikim ne trashegimine natyrore dhe historike te zones. Pranesaj nuk ndodhen vende historike, ose vende te vecanta natyrore.

Zona ne studim mbulohet nga shkurre dhe peme te shperndara. Ne kete zone gjenden edhe speciet e flores se ligatinave, zogjte, amfibet dhe reptile

Tokat me bar gjysem natyror jane toka te pashfrytezuara ne te cilat do te investohet per nje te ardhme me te mire. Potencialet bujqesore te kesaj zone vleresohen jashtezakonisht te medha.

#### **Të dhëna te pergjithshme te PDV**

- ▶ **PDV është një instrument i detajuar vendor, i cili shërben për të kontrolluar zhvillimin e territorit.**
- ▶ **PDV hartohet mbi bazën dhe sipas përcaktimeve të PPV-së, Planit të Përgjithshëm Vendor të Planifikimit të Territorit.**

Zona në studim, Nennjesia Strukturore C 2.2a/1 është nën administrimin e Bashkisë Berat. Nga pikëpamja funksionale, kjo zonë është klasifikuar si zonë e banuar.

Terreni në të cilën shtrihet PDV-ja është kryesisht një terren fushor .

Shtrihet në pjesën lindore të qytetit dhe kufizohet nga:

- V.Verit : *Aksi kryesor i rruges " Antipatrea "*
- J.Jug : *Nënnjesitë R3.1b/1*
- L.Lindje: *Nënnjesitë C2.2a/2*
- P.Perëndim: *Nënnjesitë R2.3 b/3*

#### **Parametra te Pergjithshem**

Përdorimi i lejuar	Administrative: Tregëtare: Zyra & Shërbime: Hotele: Restorante & Bare : Rezidenciale.
Përdorime të ndaluara	Të gjitha tipet e aktiviteteve prodhuese dhe përdorime përkatëse (industri, industri e lehtë, magazine etj.)
Statusi i zhvillimit	PDV
Parametrat e zhvillimit të përgjithshëm	70% tokë private; 30% përdorim publik.



#### **Rregulloret e planifikimit**

Madhësia e parcelës	Min 500 m <sup>2</sup>
( I ) Intensiteti I ndërtimit	2.5
Ksht	50%
Lartësia	26 m / 8 katësh
Distanca	Sipas rastit ato duhet të përputhen me distancat e përcaktuara në nenin 40 te VKM 502.
Kërkesa për parkime	Min 1 hapësirë parkimi për apartament
Standardet sizmike	Niveli i rrezikut nga 8-12 njësi (gradë) - MDV - 64 njësi rreziku sizmik.


### Kushtet specifike

Rregulla të tjera	Kusht për dhënien e lejeve për punime është hartimi i PDV – ve. Ato mund të hartohen vetëm pas përfundimit të procesit të legalizimit nga ALUIZNI. Madhësia e parcelës është minimumi 500 m <sup>2</sup> për njollat e reja, ndërsa për rikonstrukcione dhe shtesa mund të jepet në bazë të gjendjes egzistuese të parcelës ose gjurmës së ndërtimit. Për sa i përket kushtit, Intesitetit, lartësisë dhe distancave në raste kur nuk ka ndërtime të reja (rikonstruksione dhe shtesa në objekte egzistuese) dhe nuk plotësojnë kriteret e VKM duhet të meren deklarata nga kufitarët .
Kërkesa shtesë	Dy katet e para të strukturave mund të jenë të vazhduara ( në të njëjtën linjë me rrugën kryesore )
Aktivitetet tregëtare	Në dy katet e para . Në katin përdhe lartësia maksimale mund të jetë 5 m, ndërsa katet tip h = 3 m.

<b>Kodi i zonimit</b>	
<b>C.2.2a</b>	<b>RREGULLORE</b>
Kategoria bazë e përdorimit ekzistues	A. Banim
Kategoria bazë e përdorimit të propozuar	A. Banim + S. Shërbim
<b>Kodi i nën-njesisë strukturore</b>	<b>C.2.2a/1</b> Nën-qendra dytësore (zona e pjeshkores)
<b>Sipërfaqja totale e C.2.2a/1</b>	<b>2 ha</b>
<b>Sipërfaqja e rrugëve</b>	<b>0.24 ha</b>
<b>Nr i banorëve që pritet të shtohen</b>	<b>1500 banorë</b>
<b>Kodi i nën-njesisë strukturore</b>	<b>C.2.2a/2</b> Nën-qendra dytësore (zona e pjeshkores)
Sipërfaqja totale e C.2.2a/2	1.2 ha
Sipërfaqja e rrugëve	0.1 ha
Nr i banorëve që pritet të shtohen	900 banorë
<b>Kodi i nën-njesisë strukturore</b>	<b>C.2.2a/3</b> Nën-qendra dytësore (zona e pjeshkores)
Sipërfaqja totale e C.2.2a/3	2.7 ha
Sipërfaqja e rrugëve	0.3 ha
Nr i banorëve që pritet të shtohen	2000 banorë
<b>Kodi i nën-njesisë strukturore</b>	<b>C.2.2a/4</b> Nën-qendra dytësore
Sipërfaqja totale e C.2.2a/4	4.3 ha
Sipërfaqja e rrugëve	0.5 ha
Nr i banorëve që pritet të shtohen	2500 banorë



**BASHKIA BERAT**  
**PLANI I DETAJUAR VENDOR I NEN-NJESIS E STRUKTURE C.2.2a/1**



**SEKSIONET TËRTHORE TË RRUGËVE**

A-A. TRUPI RRUGËS 22m



B-B. TRUPI RRUGËS 16m



C-C. TRUPI RRUGËS 13m




D-D. TRUPI RRUGËS 10m



**BASHKIA BERAT** | **PLANI I DETAJUAR VENDOR I NEN-NJESIS E STRUKTURE C.2.2a/1** | **SKEMA E PROPOZUAR E RRJETIT RRUGOR** | **SEKSIONET TËRTHORE TË RRUGËVE** | **Skala: 1:1500** | **MIRATOHET** | **KRYETARI BASHKISË BERAT** | **U-07**

**BASHKIA BERAT**  
**PLANI I DETAJUAR VENDOR I NEN-NJESIS E STRUKTURE C.2.2a/1**

**TREGUESIT PËR ZHVILLIM**



TREGUESIT PËR ZHVILLIM	EKZISTUESE	Propozimi IPPV	SHIFRIMI (KATI)	Propozimi IPPV-sh	SHIFRIMI (KATI)
<b>SIPERFAQJA E NËNNJESISË</b>	28 930 m <sup>2</sup>	28 930 m <sup>2</sup>	3 kat	28 930 m <sup>2</sup>	3 kat
SIP. RRUGË	2 998 m <sup>2</sup>	0%		2 998 m <sup>2</sup>	0%
SIP. REKREATIVE	0 m <sup>2</sup>	0%		0 m <sup>2</sup>	0%
<b>SIP. NDERTIM (BAM) RUAJTJE</b>	18 765 m <sup>2</sup>	18 765 m <sup>2</sup>	12 325 m <sup>2</sup>	53 530 m <sup>2</sup>	12 325 m <sup>2</sup>
<b>SIP. NDERTIM (BAM) PRISHJE</b>	0 m <sup>2</sup>				
<b>INTENSITETI I NDERTIMIT BRUTO</b>	545	545	18	186	186
<b>Treguesit për zhvillim sipas zonave</b>	Zona	Siperfaqja bruto	Siperfaqja e ndërtimit	Shifrimi i zonave sipas kufirit të zonave	Katë të ndërtimit
<b>Zona për RIZHVILLIM</b>	A 1	10 966 m <sup>2</sup>	27 415 m <sup>2</sup>	50%	0 kat
	A 2	1 657 m <sup>2</sup>	4 143 m <sup>2</sup>	50%	0 kat
	A 3	4 770 m <sup>2</sup>	11 924 m <sup>2</sup>	50%	0 kat
<b>Totali</b>	<b>Totali zona (A)</b>	<b>17 393 m<sup>2</sup></b>	<b>43 483 m<sup>2</sup></b>	<b>50%</b>	<b>0 kat</b>
<b>Zona për RISTRUKTURIM</b>	B1-B2	11 537 m <sup>2</sup>	16 795 m <sup>2</sup> + (10 047 m <sup>2</sup> domosd) + 28 842 m <sup>2</sup>	51,52 1 334 m <sup>2</sup>	6 kat
<b>Totali</b>	<b>Nënjësia C.2.2a/1</b>	<b>28930 m<sup>2</sup></b>	<b>72 325 m<sup>2</sup></b>	<b>3 344 m<sup>2</sup></b>	

**BASHKIA BERAT** | **PLANI I DETAJUAR VENDOR I NEN-NJESIS E STRUKTURE C.2.2a/1** | **TREGUESIT PËR ZHVILLIM** | **TREGUESIT PËR ZHVILLIM** | **Skala: 1:2000** | **MIRATOHET** | **KRYETARI BASHKISË BERAT** | **U-09**



Foto nga zona ne studim



## TREGUESIT MJEDISORË

### Cilësia e ajrit, ujrave dhe tokës

#### Ndotja e ujit:

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Shërbimeve (Specialistes së Mjedisit), rezulton që ndotja e ujit të pijshëm në qytet njih këto indekse: 0, 2, 4 dhe 6 %. Kjo ndotje vjen si rezultat i klorifikimit të ujit. Dozat me të cilat ai klorinifikohet ndikojnë në këtë masë duke rritur nitratat, etj.

Në ndotjen e ambientit ndikojnë shumë faktorë dhe ndër të cilat veçojmë: metalurgjia e plumbit, punishtet e gurit dhe të mermerit, punimet metalike, depoja dhe punishtja e lëkurave.

Ende deri tani nuk ka pajisje për të matur zhurmat.

Mbështetur në parametrat fiziko-kimikë të ujrave dhe në metalet e rënda në ujra, lumi Osum bën pjesë në Klasën II të ujrave dhe me ndotje të theksuar për metalet e rënda.

### Projekti i integruar per kanalizimet, kullimin dhe infrastrukturën e transportit dhe të parkut lumor

Ky projekt integron një zgjidhje për problemin e ujrave të ndotura, rregullimin e plotave të lumit Osum, krijimin e një korridori të infrastrukturës kryesore dhe zhvillimin e një parku linear përgjatë lumit. Korridori kryesor i infrastrukturës do të përbëhet nga një system kanalizimesh grumbullues, i cili do të përfundojë në një impiant trajtimi të ujrave të zeza, zgjerimi i rrugës përgjate lumit, duke përfshirë infrastrukturën suplementare te furnizimit me ujë, kabllot e telekomunikacionit dhe kështu me radhë. Projekti do të sigurojë shtylla kurrizore bazë të infrastrukturës së qytetit, duke përfshirë edhe zhvillimin e Parkut Lumor, për të siguruar dhepërmirësuar lidhjet në mes pjesëve të qytetit dhe midis tyre dhe lumit.

### **Krijimi i një sistemi kompleks të grumbullimit të mbetjeve**

Projekti ka për qëllim për të pastruar qytetin, nëpërmjet futjes së një sistemi të integruar dhe funksional të mbledhjes së mbeturinave, duke përfshirë programe riciklimi dhe trajtimi të mbeturinave industriale dhe sanitare, rehabilitimin e landfillit të vjetër dhe ndërtimin e një të riu. Kjo do të ndikojë shumë në imazhin e qytetit duke parandaluar rreziqet e shëndetit dhe të mjedisit dhe duke siguruar një cilësi më të mirë të jetës.

### **Rehabilitimi i ish-vendit të fabrikës së baterive**

Trajtimi i ujrave dhe tokës së kontaminuar, i cili do të reduktojë dëmet mjedisore dhe rreziqet për shëndetin publik.

### **Përmirësimi i sistemit bashkiak të furnizimit me ujë**

Kjo do të përfshijë riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemin ekzistues të furnizimit dhe zgjerimin në zonat e pafurnizuara, për të siguruar kështu një cilësi të mirë të jetesës.

### **Tregu industrial**

Kjo do të përfshijë zhvillimin e një tregu të ri industrial, me një system efektiv të menaxhimit, nëpërmjet mbledhjes së taksave dhe shfrytëzimit normal të tij.

### **Rehabilitimi i rrugëve**

Përmirësimet e pritura në cilësinë e jetës dhe të standarteve të jetesës, si dhe rritja e ardhshme e përdorimit të automjeteve private, kërkon zhvillimin dhe riparimin e rrjetit rrugor të qytetit. Kjo përfshin edhe sigurimin e rrugëve dhe lidhjen e tyre me zonat informale, zgjerimin e rrugës së lumit dhe sigurimin e një rrugë unazë, si dhe by-passin e qytetit, të gjitha për të plotësuar nevojën për lidhje më të mirë të qytetit dhe menaxhimin më të mirë të trafikut.

### **Rehabilitimi i vendgrumbullimit të mbetjeve**

Rehabilitimi i vendit të tanishëm, që gjendet përgjatë lumit, është i nevojshëm për të parandaluar ndotjen e mëtejshme dhe rreziqe për shëndetin, ndotjen e tokës dhe ujit të cilat ndikojnë në lumë dhe zonat e afërta të banimit.

### **Rrjeti i hapësirave të hapura**

Zhvillimi dhe menaxhimi i hapësirave të hapura të qytetit do të përmirësojë cilësinë e jetës për banorët dhe vizitorët, rritjen e aksesit të tyre dhe sigurimin e hapësirave për pushim dhe kohë të lirë.

### **Rrjeti i përdorueseve të biçikletave dhe këmbësorëve**

Kjo është e lidhur me zhvillimin e një rrjeti gjithëpërfshirës të transportit plotësues dhe me forma të reja (në funksion të terrenit), të cilat do të sigurojnë rënien e vartësisë nga automjeti dhe mjetet e motorizuara, duke ndikuar direkt në reduktimin e nivelit të ndotjes, promovimin e komoditetit të publikut dhe mbrojtjen e shëndetit publik përmes aktivitetit fizik.

## **PARIME TË PËRGJITHSHME MBI TË CILAT DUHET TË MBËSHTETET PLANI I PËRGJITHSHEM VENDOR**

Është e rëndësishme që Plani i Përgjithshëm Vendor të mbështetet në këta parime bazë:

- *Të jetë një instrument për menaxhimin e qytetit dhe të përcaktojë strategjinë e zhvillimit mbi bazën e realitetit dhe objektivave kryesore;*
- *Të respektojë të drejtën e banorëve për të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve të qytetit;*
- *Të përcaktojë principet e zhvillimit mbi bazën e rregullave të domosdoshme për siguruar interesin publik;*
- *Të jetë një kornizë koordinimi midis hapësirës, potencialit për investime dhe institucioneve.*

## **NDIKIMET MJEDISORE**

### **PËRSHKRIMI I PLANIT TË DETAJUAR VENDOR**

Plani i Përgjithshëm Vendor i qytetit të Beratit përfshin një material të bollshëm të gjendjes ekzistuese të qytetit të përfshira në detyrën e projektimit dhe një analizë të hollësishme të njësive dhe nënjësive strukturore të qytetit për perspektivën 15-vjeçare.

Zona e planifikuar në studim është sipërfaqe e cila do të përfshijë një popullsi prej 1500 banorë, sipërfaqja totale 2 ha dhe sipërfaqe e rrugëve 0.24 ha.

Realizimi me sukses i tij mund të arrihet vetëm nëse kombinohen masa të natyrës urbanistike dhe ekonomike me anën e të cilave propozohen ndërhyrje konkrete në territorin e qytetit. Këto ndërhyrje kënaqin interesat e palëve dhe ndërkohë respektojnë mjedisin, si baza jetësore e zhvillimit të tyre. Këto ndërhyrje nxisin një sërë aktivitete të reja ekonomike, sociale e kulturore, përmirësojnë strukturën hapësinore të territorit, dhe sigurojnë instrumente që ruajnë burimet natyrore.

Me qëllim arrijen e një bashkëveprimi në unison midis elementëve të mësipërm, plani krijon një kornizë urbane.

### **NDIKIMET NGA PROJEKTI I PLANIT TË DETAJUAR VENDOR**

#### **Ndikime që shoqërojnë transportimin e materialeve të ndërtimit**

Transportimi i një sasive relativisht të madhe të materialeve të ndërtimit në pika të ndryshme të qytetit, është përbërës i rëndësishëm i veprimtarisë ndërtimore. Trafiku transportues jo vetëm rrit dukshëm volumin total të trafikut ditor në rrugët ekzistuese, por do të rritë në mënyrë të konsiderueshme numrin e makinave të rënda. Këta faktorë do të çonin në një rritje të rëndimit ose bllokimit në trafik. Rëndimi në rritje në kohën e pikut të trafikut herët në mëngjes dhe vonë pas drake mund të shqetësojë përdoruesit e tjerë të rrugës dhe gjithashtu çon në rritjen e aksidenteve në saj të frustrimit që krijohet nga lëvizja e ngadaltë e makinave të rënda. Makinat me ngarkesë bosh në këthim që tentojnë të lëvizin shumë shpejt, do të kontribuojnë në rritjen e rrezikut për përdoruesit e rrugës.

#### **Ndikimet që shoqërojnë gërmimet e dheut**

Në Planin e Detajuar Vendor nuk parashikohen raste ku punimet me dherat të rrezikojnë rrëshqitje të shpateve, për të cilat nga ana e eksperteve gjeoteknike do të kërkohej rregullimi përkatës për gjeometrinë natyrore të shpateve.

#### **Humbja e drurëve në anë të rrugëve**

Nevoja për zgjerimin e rrugëve ekzistuese do të çonte në mënyrë të pashmangshme në humbjen e drurëve anës rrugëve në disa vende. Numri që do të duhej të vlerësohej, do të ishte relativisht i vogël. Vetëm një numër i pakët drurësh të mëdhenj ka gjasë të preken. Spastrimi i drurëve (pyjorë ose frutorë) mund të ketë një ndikim mbi pronarët në terma të humbjes së një vlere, që mund të kontribuojë në të ardhura ose mjete jetese dhe në banorët lokalë dhe përdoruesit e rrugëve në përgjithësi, humbjen e një tipari, që përmirëson paraqitjen estetike të rrugëve.

Nga pikëpamja faktike këta pak drurë relativisht të prekur, ndikimin e kanë të ulët.

Megjithatë, një numër shumë i madh shkurresh përgjatë anës së rrugëve do të hiqen. Në këtë rast është parashikuar që mbjellja e drurëve dhe bordurave të gjelbëra do të ishte fitimprurëse dhe do të caktohet në kontratën ndërtimore.

### **Ndikime përfituese**

Gjatë zbatimit të P.D.V do të gjenerohen të ardhura lokale nga veprimtaritë e ndryshme ndërtimore, si rezultat i krijimit të vendeve të reja të punës.

### **Ndikime mjedisore, humane dhe shoqërore**

#### **Mjedisi natyror**

- Pritet një keqësim i cilësisë së ajrit si pasojë e pluhurit dhe tymit në vendndërtime, në hapësirat e parashikuara për ndërhyrje urbane, rrugëve që do të ndërtohen të reja sipas P.D.V ose do të rikonstruktohen, rrugëve të pasistemuara ose të pashtruara në fazën e parë të zbatimit të P.D.V dhe impianteve të ndërtimit dhe ato të asfaltimit që ndodhen brenda qytetit dhe kanë ndikim direkt në jetën e qytetarëve.
- Rritje e nivelit të zhurmave që krijohen prej aktivitetit ndërtimor dhe që janë te pranishme gjatë gjithë fazës së zbatimit të P.D.V;
- Gjenerimi dhe eliminimi i papërshtatshëm i mbetjeve ndërtimore;
- Përdorimi i mjedisëve dhe sipërfaqeve të papërshtatshme për depozitim dhe përpunimin e materialeve që përdoren për ndërtime, me pasojë dëmtimin e mjedisit natyror (prerje pemësh, ndërhyrje në sipërfaqet e gjelbëruara, etj);
- Erozioni i tokës që vjen nga ndërhyrjet në hapësirat ndërtimore të planifikuara duke shkaktuar rritje të turbiditetit të ujit në rrjedhat ujore;
- Kontaminimi i ujrave sipërfaqore me mbetje ndërtimore gjatë prishjes së ndërtimeve të vjetra si pasojë e mungesës së mundësive për ripërdorim dhe riciklim;
- Kontaminimi i ujrave sipërfaqore me lëndë të rrezikshme, si asfalte dhe bitume gjatë ndërtimit të rrugëve;
- Pakësimi i sipërfaqeve të gjelbëra në rastet kur plani parashikon zgjerim të rrugëve ose ndërtimin e tyre në zona me gjelbërim;
- Humbja e disa drurëve frutore dhe kopshteve me perime në njësitë dhe nënjësitë strukturore që janë parashikuar me ndërtime urbane dhe rrugë.

Shumica e ndikimeve të paraqitura më sipër kanë natyrë të përkohshme, por disa prej tyre do të kenë ndikim negativ dhe afatgjatë dhe do të shoqërojnë gjithë kohën e zbatimit të P.D.V. Masa zbutëse të përshtatshme janë paraqitur më tej në këtë raport, për çdo njësi dhe nënjësi strukturore të planifikuara në studimin hapësinor të qytetit të Beratit. Shumë nga ndërtimet do të kryhen në vendet e ish-godinave të vjetra kështu që dëmtimet në hapësirë dhe në tokë nuk do të jenë të mëdha. Ndikim kryesor kanë prerja e drurëve dhe bimësisë anës rrugëve për zgjerimin e tyre si pasojë e nevojës së një periudhe disa vjeçare për ripërtëritjen e tyre.

#### **Mjedisi human**

Ndikimi i Planit të Detajuar Vendor mbi mjedisin human përfshin:

#### **Shpronësimi dhe përdorimi i tokës**

Krijimi i shesheve për ndërtime, si dhe zgjerimet e rrugëve kërkojnë edhe shpronësimin e tokës së planifikuara nga P.D.V. Në rastin konkret nuk do të kemi shpronësime pasi nuk kemi të bëjmë me pronësi të shtetit por me pronësi private.

Lidhur me përdorimin e tokës, siç u tha edhe më lart, pjesa më e madhe e saj në nënjësinë strukturore C 2.2 a/1, është në pronësi të privatit, si rrjedhojë nuk priten probleme madhore në lidhje me shpronësimin.

### **Ndikimet mbi monumentet e kulturës**

Në Planin e Detajuar Vendor nuk ka raste që ndërtimet mund të kryhen afër monumenteve të kulturës, si kisha, xhamia e qytetit, objekte që janë shpallur monumente kulture, etj. Edhe objektet arkeologjike, që mund të rezultojnë gjatë gërmimeve për ndërtimin e objekteve të reja, do të mbrohen dhe do të ruhen të paprekur duke krijuar kushte për konservimin e trajtimin sa më të mirë të tyre në të ardhmen.

### **Ndikimet të përkohshme**

Mjedisi lokal dhe banorët përreth do të ekspozohen ndaj pluhurave, tymrave dhe mbetjeve ndërtimore që do të krijohen nga punimet e zbatimit të P.D.V. Si pasojë e makinave të rënda që do të përdoren për ndërtime dhe rikonstruksionin e objekteve ekzistuese, është e pritshme një rritje e sasisë së emetuar të tymrave dhe gazrave, e cila do të jetë më e madhe në periudhën e verës, për vetë volumin më të madh të punimeve që kryhen në këtë stinë. Trafiku i tepruar gjatë kësaj periudhe do të jetë mjaft shqetësues në krijimin e pluhurave dhe ekspozimi i banorëve ndaj zhurmave mbi nivelet e lejuara nga makineritë e rënda do të krijojë stres nervor, i dëmshëm për shëndetin e tyre.

### **Ndikime përfituese**

Gjatë zbatimit të P.D.V do të gjenerohen të ardhura lokale nga veprimtaritë e ndryshme ndërtimore. Në krahasim me projektet e tjerë të zhvilluar në qytet, ky plan ka të ngjarë të sigurojë punë për një numër të madh personash. Sa më shumë kantjere ndërtimi, aq më shumë firma, dhe për pasojë aq më shumë vende pune e të ardhura do të sigurohen.

Biznesi lokal do të përfitojë nga rritja e fuqisë blerëse që vjen si pasojë e punësimit.

Punësimi rritet gjatë periudhës ndërtimore dhe do të përbëjë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare. Popullsia lokale do të mundë të ketë rastin të përfitojë aftësi të reja në punë, zeje, tregëti, etj.

### **Ndikimet që shoqërojnë zbatimin e planit të përgjithshëm vendor**

#### **Mjedisi Natyror**

Zbatimi i Planit të Detajuar Vendor do të rezultojë me shkarkimin e ndotësve, si vajrat dhe metalet e rënda që do të depërtojnë në tokë si pasojë e shplarjes së rrugëve nga ujrat atmosferike. Kjo do të shkaktohet me rritjen e nivelit të trafikut si rezultat i ndërtimeve dhe përmirësimit të rrugëve.

Pritet që shkarkimet e substancave helmuese të ulen me rritjen e shpejtësisë dhe në saj të cilësisë më të mirë të karburanteve. Sidoqoftë, shkarkimet mundet gjithashtu të shtohen për shkak të konsumit të lartë të lëndëve djegëse, që i korrespondojnë shpejtësisë së lartë të makinerive. Një rritje e ndotjes së ajrit, në një farë shkalle, do të kompensohet me përmirësimin e teknologjisë për kontrollin e shkarkimeve nga makineritë e importuara.

Me përmirësimin e rrugëve, niveli i zhurmave do të ulet. Aktualisht, automjetet shpesh ulin shpejtësinë, pastaj e rrisin, për të mënjeluar ose për të kapercyer segmente të dobëta të rrugëve. Nuk dihet në se ka lloje faunistike të rrezikuara (gjitarë, shpendë, amfibë, etj.) në hapësirat ndërtimore.

Më poshtë, jepen ndotjet kryesore si rezultat i shkarkimit në mjedis:

- Shkarkimi i tymrave nga motorët diesel (përfshirë pjesëzat e hidrokarbureve aromatike policiklike të absorbueshme);
- Trafiku në rritje do të shkaktojë më shumë shkarkime plumbi, si pasojë e përdorimit të benzines me plumb)
- Shtimi i shkarkimeve të CO, CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub>, pjesëzave, metaleve të rënda dhe aerosoleve si pasojë e rritjes së dendësisë së trafikut;

- Gjenerimi i filmit të naftës në sipërfaqe të rrugëve dhe depërtimi i naftës dhe ndotësve të tjere në toke
- Kontaminimi i rrjedhave ujore me film HC dhe pluhur të kontaminuar;
- Kontaminimi i ujrave nëntokësore me HC, pluhur të kontaminuar, etj.

### **Mjedisi human**

Ka një migrim domethënës të popullsisë nga zonat urale në ato urbane gjatë 18 vjetëve të fundit. Ngritja e banesave të reja në qytet si dhe përmirësimi i rrugëve kanë çuar në përmirësimin e kushteve jetësore, ekonomike–shoqërore për popullsinë. Përmirësimi i kushteve të jetesës ka ndikim të dukshëm në shërbimet publike. Në Planin e Detajuar Vendor janë parashikuar përmirësime të mjedisit (peisazhit, hapësirave të gjelbëra, territoreve të lira, modelit të ngulimeve, terrreneve sportive) që rregullojnë dhe përmiresojne ndjeshëm cilësinë e jetës së banorëve.

### **Rritja e rreziqeve të sigurisë rrugore**

Përmirësimi i rrugëve do të çojë në kalimin e sigurt të automjeteve, kryesisht përmes përmirësimit në gjeometri dhe sipërfaqes së asfaltuar. Përveç kësaj, rrugët do të jenë të gjera, aq sa automjetet që udhëtojnë në drejtime të kundërta të kalojnë butë.

P.D.V ka parashikuar akset kryesore të rrugëve të rritit primar në përputhje me numrin e automjeteve dhe të popullsisë që do të qarkullojë në rrugë për 20 vitet e ardhshme. Për këtë janë planifikuar të gjitha seksionet e rrugëve, skemat e qarkullimit rrugor, sheshet e parkimeve, sinjalistika vertikale dhe horizontale për të gjitha rrugët.

Sidoqoftë, niveli i trafikut pritet të rritet, dhe sipërfaqja udhëtuese e përmirësuar do të lejojë shpejtësi automjetesh më të larta se sa tani. Për pasojë, ka mundësi që të ketë rritje të rreziqeve për këmbësorët, së bashku me një rritje në numër dhe shpeshtësi të aksidenteve automobilistike.

Nyjet dhe kryqëzimet e rrugëve janë pika rreziku që rritet çdo ditë e më tepër me rritjen e numrit të automjeteve në qytet. Së bashku me rritjen e numrit të mjeteve, rritet edhe numri i aksidenteve dhe ndotja e ambientit.

Në përgjithësi, pritet që rreziqet e sigurimit rrugor do të rriten në rradhë të parë në ata sektorë që kalojnë përmes vendeve të hapura ose pranë vendbanimeve të vogla gjatë rrugës. Ndërtimet në anë të rrugës nacionale rrisin rrezikshmërinë e jetës së njeriut. Sidoqoftë, vënia e shenjave rrugore dhe treguesve rrugorë në pikat e konflikteve potenciale, përmirëson sigurinë rrugore për të gjithë përdoruesit.

### **Ndikimet përfituese**

- Ulja e sasisë së gazeve, tymrave dhe pluhrave të shkarkuara nga trafiku. Në saje të shpejtësisë së madhe, djegia e karburanteve është më efektive, që u korrespondon shkarkimeve më të ulta të gazeve toksikë. Megjithatë, një shpejtësi më e madhe çon në një konsum të rritur të lëndës djegëse që gjeneron gaz serë (CO<sub>2</sub>, etj.).
- Përmirësimi i drenazhit të rrugëve; ulja e numrit të aksidenteve si rezultat i përmirësimit të kushteve sipërfaqësore të rrugëve.
- Përfitime social–ekonomike. Shitja drejtpërdrejt në anë të rrugës do të rrisë të ardhurat dhe mallrat transportohen shumë më shpejt se tani (ulet kostoja e transportit dhe komoditeti rritet). Ulet kostoja operationale e automjeteve si rezultat i përmirësimit të gjeometrisë vertikale e horizontale të rrugëve dhe përmirësohet cilësia e drejtimit të automjeteve.

## **VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I PERFORMANCËS MJEDISORE**

Natyra e Planit të Detajuar Vendor të nennjesise strukturore C 2.2 a/1 është e tillë që shumica e punimeve realizohen në renditjen ekzistuese, kështu që shmanget ose pakësohet shkalla e efekteve keqësuese.

Gjatë fazës operacionale shkalla e ndërtimeve, niveli i trafikut etj, kanë pak gjasa të jenë mjaft të lartë në atë shkallë sa të shkaktojnë shqetësime në lidhje me zhurmat, ndotjen e ajrit ose lëvizjen e automjeteve dhe këmbësorëve.

Disa hapësira te zones ne studim nuk preken nga shpronësimet e tokës pasi janë prona private te cilat do te jepen për sheshe ndërtimi, punime ujësjellësish, rrjeti elektrik, rrugë të reja apo zgjerim të tyre, që janë të parashikuara në P.D.V. Nuk ka zhvendosje në masë të popullsisë pasi e gjithë zona është e pa zhvilluar të gjitha llojet e punimeve kryhen në vende të lokalizuara, në breza të caktuar.

Në fazën ndërtimore të P.D.V ndikimet keqësuese mund të zbuten kënaqshëm, ose me anën e projektimit të mirë inxhinierik, ose përmes adoptimit dhe përforcimit të kushteve mbrojtëse mjedisore në kontratat ndërtimore. Megjithatë do të jenë të pranishëm rreziqet e sigurimit rrugor në rritje me shpejtësinë e madhe të automjeteve dhe volumin më të madh të trafikut gjatë operimeve.

Ndikimet më të rëndësishme mjedisore dhe sociale janë si vijon:

- Humbje e drurëve, shkurreve e gjerdeve të gjelbër;
- Pluhur dhe ngritje tymi në stadin ndërtimor që mund të shkaktojë probleme në banorët pranë objekteve të ndërtimit;
- Mungesa e vendeve për depozitimin e gjitha mbetjeve të përdorshme të ndërtimit;
- Përdorimi përgjithësisht i ujit gjatë stadi të ndërtimit pa trajtim të përshtatshëm para përdorimit.

## **MASAT ZBUTËSE DHE MASAT PËR RITJEN E PËRFITIMEVE MJEDISORE**

### **Masat zbutëse**

Masat zbutëse dhe vlerësuese për t'u marrë janë të shumëllojshme. Masat kryesore janë paraqitur shkurt për fazat (stadet) ndërtimore dhe zbatuese të P.D.V të zones ne studim. Masat janë ndarë në masa zbutëse të detyrueshme dhe në masa zbutëse të rekomanduara shtesë.

### **Stadi ndërtimor zbatues. Masa zbutëse të detyrueshme**

- Për të pakësuar ndikimet nga shpronësimet e tokës dhe pronës, projektet inxhinierike do të përgatiten në atë mënyrë që shpronësimi i tokës dhe pronës të jetë në minimum;
- Të pakësohet në minimum ndotja e tokës dhe burimeve ujore në sheshet e ndërtimit të kontraktuesve dhe vendet e punës si pasojë e keqfunksionimit të ambjenteve sanitare, krijimit të mbetjeve si dhe rrezikut të derdhjeve dhe rrjedhjeve të materialeve ndotëse. Kontraktorëve do t'u kërkohet të bëjnë projekt-propozimet e tyre për të parandaluar dhe minimizuar këto burime potenciale të ndotjes;
- Futja e teknologjisë së re në ndërtim me nivel të ulët zhurme dhe përdorimi i mjeteve me goma;
- Prerja e asfalteve me teknologjinë e kohës, pa zhurmë dhe pluhur (me përdorim uji);
- Përdorimi i mjeteve të mbuluara për largimin e mbetjeve të ndërtimit që shkaktojnë ndotje suplementare, dhe riciklimi i mbetjeve të ndërtimit që mund të ripërdoren.(asfaltet, hekurat e ndërtimit, pjesë metalike, etj.);
- Filtrimi i ujrave që ngelen nga përdorimi në fushën e ndërtimit dhe që ndotin tokën (ujrat me çimento, me acide, lëng xhami, ujrata e makinerive të ndërtimit);
- Të gjitha ujrata e kontaminuara që përdoren në ndërtime do të trajtohen në mënyrë të përshtatshme. Rekomandohet që uji duhet së pari të kalojë në një seri filtrash ku përdoret edhe rëra ose pelleggje precipitimi dhe së fundi, të infiltrohet në tokë ose të derdhet në lumë;

- Të merren të gjitha masat për të siguruar nivelin e duhur të sigurisë dhe higjienës në punë (pajisja e punëtorëve me doreza, maska mbrojtëse, helmetë, etj);
- Spërkatja me ujë e sipërfaqeve të rrugëve të pashtuara për të evituar ngritjen e pluhrave gjatë periudhave me thatësi;
- Minimizimi i sasive të mbetjeve të kantjerit nëpërmjet ripërdorimit të tyre. Depozitimi përfundimtar i mbetjeve ndërtimore është përgjegjësi e kontraktuesve në bashkëpunim me autoritetet bashkiake. Është i nevojshëm një asgjësim përfundimtar dhe i përshtatshëm i mbetjeve;
- Me qëllim që të pakësohet shkarkimi i tymrave dhe shtimi i zhurmave, kontraktuesit duhet të mundësojnë përdorimin e makinerive moderne me nivel të ulët zhurme dhe shkarkime të ulta të gazeve dhe tymrave;
- Me qëllim që të ulët ndikimi për banorët dhe mjedisin, duhet bërë monitorimi për të kontrolluar parametrat kryesorë ndotës gjatë ndërtimit (pluhur, zhurmë, kontaminim uji, mbetje të ngurta);
- Të shihen të gjitha mundësitë e ripërdorimit të shtresave dhe asfalteve, me synon përdorimin e hedhjes së tyre në vende të papërshtatshme.

#### **Stadi ndërtimor zbatues. Masa zbutëse të rekomanduara shtesë**

- Sisteme sinjalizimi të përkohshme trafiku dhe shenja rrugore për të rritur sigurinë rrugore gjatë ndërtimit;
- Në terrenet ku banesat janë ngjitur me rrugët, puna duhet të kryhet vetëm gjatë ditës për të mënjanuar zhurmën, pluhurin dhe shkarkimin e tymit gjatë natës.

#### **Stadi i shfrytëzimit. Masa zbutëse të detyrueshme**

- Uji që vjen prej sipërfaqeve të ndërtimeve duhet të mblidhet duke përdorur një sistem drenazhimi. Vija (rryma) e infiltrimit në tokë duhet të jetë sa më e gjatë të jetë e mundur. Uji nuk duhet t'i drejtohet mjedisit receptor nëse është i kontaminuar me substanca organike dhe inorganike;
- Atje ku drurët dhe bordurat e gjelbëra duhet të priten për vendosjen e objekteve ndërtimore, duhet të bëhet zëvendësimi i tyre kudo ku është e mundur;
- Gardhet e gjelbër duhen rimbjellë pasi ata ndihmojnë pakësimin e pluhrave dhe shkarkimeve të tjera dhe ruajnë banesat ngjitur me rrugën;
- Pavarësisht nga rritja e shpejtësisë së makinave, siguria rrugore duhet të përmirësohet me sinjaletikë të përshtatshme rrugore, shënime rrugore dhe kontroll policor;
- Përdorimi i mbikalimeve për të siguruar banorët nga aksidentet;
- Implementimi i një sistemi monitorimi mjedisor për kontrollin e cilësisë së ajrit dhe të ujit;

#### **REKOMANDIME PËR STADET E NDËRTIMIT DHE PËRDORIMIT**

Për të pakësuar ndikimin që shoqëron shpronësimin e tokës dhe pronës rekomandohet të adoptohen tre parime themelore:

- Projektet inxhinierike të përgatiten të tillë që shkalla e shpronësimit të tokës dhe pronës të jetë minimale;
- Kompensimi i plotë dhe CASH t'u paguhet të gjithë atyre që preken nga shpronësimi i tokës dhe pronës;
- Organet kompetente duhet të fillojnë diskutimet me autoritetet bashkiake për vendosjen e opsioneve të përshtatshme për rivendosjen e bizneseve të prekur potencialisht në vendet e duhura alternative;



Do të jepen konsiderata për shtendosjen e standarteve të projekteve që të çojnë në pakësimin e shpronësimeve të tokës dhe pasurive pa kompromentim domethënës të funksioneve të objekteve.

Zbutja efektive mundësohet duke u kërkuar kontraktuesve të marrin të gjitha masat paraprake për pakësimin e ndotjes dhe për të siguruar këtë të gjitha vendet vihen në kushte të pastra e të rregullta për të përmbushur punimet e ndërtimit. Ndikimet mund minimizohen duke u kërkuar kontraktuesve të kryejnë rregullimet për një furnizim privat me ujë, që nuk do të prekte të drejtën e të tjerëve.

Pakësimi efektiv i mbetjeve mundësohet vetëm me sigurimin e një sistemimi në mënyrë të kontrolluar dhe vetëm në vendet e zgjedhura për këtë qëllim.

Gjatë stadiit të projektimit të hollësishëm do të identifikohen vendet për sistemimin e dherave të ndërtimit duke llogaritur nevojat, për të pakësuar efektet potenciale keqësuese në minimum.

Do të bëhen përpjekje për identifikimin e vendeve si guroret e vjetra dhe gropat, të cilat mund të rimbushen, pa pasur nevojë për të gjetur vende të reja.

Konsulentet e projekteve do të përfshijnë mënyra dhe modele të përshtatëshme në punime të përhershme për minimizimin e erozionit kudo që të çfaqet duke përfshirë edhe sistemet e duhura të drenazhimit.

Në të gjitha llojet e punimeve do të minimizohet prerja e drurëve pa kompromentuar gjeometrinë e rrugëve. Atje ku drurët duhet të priten për të rregulluar punët e ndërtimit kompensimi dhe zëvendësimi i plotë i tyre duhet të paguhet.

## **REKOMANDIME QË LIDHEN ME MUNGESËN E INFORMACIONIT DHE AKTIVITETET E MËTEJSHME**

Pavarësisht identifikimit të impakteve, si dhe propozimit të masave zbutëse ndaj tyre nga VNM, rekomandohet që të bëhen disa investigime shtesë:

- Organizimi i pjesëmarrjes publike për P.P.R të qytetit të Beratit. Organizimi i ditëve të hapura të Beratit, ku qytetarët mund të diskutojnë ndonjë shqetësim mjedisor që mund të kenë;
- Intervistimi i banorëve që jetojnë pranë objekteve që propozohen të ndërtohen gjatë grumbullimit të të dhënave për stadin e shpronësimit të tokës. Çdo shqetësim serioz duhet të diskutohet me klientët dhe të merren masa zbutëse të përshtatëshme.

## **DISPOZITAT PER PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE MJEDISORE**

Propozohet të përfshihen klauzolat e listuara më poshtë në dokumentet e tenderave.

### **Kushtet kontraktore**

Klauzolat lidhur me kushtet duhet të përfshihen në kontratat e ndërtimit me qëllim që kontraktuesit:

- Të përgatisin vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) për sheshin e ndërtimit dhe gjithë vendet e tjera para se të fillojnë stabilizimin e sheshit të ndërtimit dhe çfarëdolloj pune ndërtimore;
- VNM duhet të bëjë parapërgatitje specifike të përshtatëshme për sistemin e mbetjeve sanitare e të tjera në një mënyrë që nuk do të rezultonte asnjë formë ndotje ose rreziku për shëndetin e njerëzve ose kafshëve;
- Të marrin masa të arsyeshme paraprake për të ndaluar derdhjet dhe rrjedhjet e materialeve me mundësi për të ndotur vendin ose burimet ujore dhe të përshkruhen hollësisht masat që ata propozojnë të adoptojnë në VNM. Masat paraprake do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në masa fizike. Masat do të mbahen në kushte efektive gjatë gjithë periudhës kontraktuese;
- Të jenë përgjegjës për pastrimin e çfarëdo ndotjeje të shkaktuar me aktivitetin e tyre dhe të paguajnë për atë që kanë dëmtuar (shkaktuar);

- Të sigurojnë që sheshet e ndërtimit dhe të gjithë vendet e punës të lihen në gjendje të qetë e të pastër në përfundim të punës ndërtimore dhe vendet të rikthehen, sa më shumë të jetë e mundur, në gjendjen e tyre origjinale;
- Të jenë përgjegjës për të bërë rregullimet e duhura për furnizimin me ujë për ndërtime dhe qëllime të tjera dhe kjo mos të prekë cilësinë ose aftësinë e burimeve të ujrave mbi e nëntokësorë të përdoruesve ekzistues;
- VNM-ja e kontraktuesve duhet të përfshijë hollësi për rregullimet e tyre, të propozuara lidhur me furnizimin me ujë për qëllime ndërtimi.

Përveç të tjerave, klauzolat duhet të përfshihen në kontratën e ndërtimit, që kontraktuesi:

- Të specifikojë me hollësi “ Programin e punës ” të përgatitur gjatë periudhës së mobilizimit, datën më të herëshme në të cilën do të fillojnë punimet ndërtimore në çdo vend ku mund të kërkohet rivendosja e shërbimit;
- Të jetë përgjegjës për marrjen dhe verifikimin e informacionit për të gjithë shërbimet ekzistuese që ndodhen brenda ose ngjitur punimeve ndërtimore dhe për sigurimin e tyre që asnjë dëmtim nuk do t’u shkaktohet gjatë punimeve;
- Të sigurohen që gjithë prishjet ndërtimore do të depozitohen në vendet e miratuara;
- Të ndalohen të mbahen pjesë me rrezik shembjeje;
- Të përgatiten VNM për çdo sistemim prishesh të propozuara para fillimit të aktivitetit sistemues në çdo vend. Çdo VNM do të ketë një plan të konturuar në një shkallë të përshtatshme, duke treguar vendvendosjen dhe ndonjë rrugë lehtësimi të propozuar, sipërfaqen maksimale që do të përdoret për sistemimin e objekteve të prishura, përdorimin aktual të tokës dhe hollësi për pronësinë. VNM duhet të ketë gjendjen e masave që do të adoptohen për të siguruar qëndrueshmëri të materialeve që rezultojnë nga prishja dhe të minimizojnë erozionin gjatë vendosjes së tyre;
- Të hidhen të gjitha hapat e arsyeshëm në rastin e rrugëve, për të minimizuar të papriturat e pakëndshme dhe rreziqet rrugore të përdoruesve të tjerë. Përveç të tjerave të rregullohet koha e transportimit për të shmangur pikun e trafikut;
- Të merren masat e duhura për minimizimin e rreziqeve rrugore duke i shoqëruar ato me një diversitet kohor trafiku gjatë çdo aktiviteti ndërtimor;
- Të jetë përgjegjës për heqjen e mbeturinave të përkohshme pas përfundimit të ndërtimit dhe për të kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme tokën dhe burimet ujore.
- Një kthim i tillë duhet të përfshijë edhe heqjen e gjithë materialeve të rezultuara, rindërtimin e tarracave dhe shkëmbimin e thellë të tokës së ngjeshur në trojet bujqësore;
- Të përdorë makina për punë ndërtimore, makineri e materiale që kanë tipe dhe kapacitete të përshtatshme për përdorimet e tyre të synuara;
- Të bëjnë riparimet e duhura për strukturat ndërtimore ose shtrimin e rrugëve që do të paraqesin dëmtime si rezultat i pakujdesive ose nga kalimi i automjeteve.

## **PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR**

Monitorimi mjedisor është i domosdoshëm për të ndjekur ecurinë e zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit. Monitorimi në qytetin e Beratit kryhet nga Instituti i Shëndetit Publik (Departamenti i Shëndetit Mjedisor). Instituti është pajisur mirë me aparatura të përshtatshme, ka përvojë shumëvjeçare në monitorimin mjedisor si dhe një staf të trajnuar shkencërisht për kryerjen e analizave. Disa pika do të vendosen në qytet për analizat e ajrit. Analizat do të vazhdojnë të kryhen në gjithë stadet e P.D.V. Analizat e ajrit dhe të ujit do të kryhen sipas një plani monitorimi.

## **Monitorimi mjedisor**

### **Analizat e ajrit**

Rekomandohet të kryhen analiza të cilësisë së ajrit gjatë fazës (stadit) të ndërtimit në të gjitha pikat e monitorimit si vijon:

- Lënda e ngurtë pezull LGS;
- Grimcat PM10
- Dyoksidi i squfurit SO<sub>2</sub>;
- Dyoksidi i azotit NO<sub>2</sub>;
- Ozoni O<sub>3</sub>;
- Plumbi Pb.

Të njëjtat pika monitorimi mund të përdoren gjatë fazës së zbatimit. Parametrat që analizohen janë:

- Grimcat PM10;
- Dyoksidi i squfurit SO<sub>2</sub>;
- Oksidet e azotit NO<sub>x</sub>;
- Monoksidi i karbonit CO;
- Hidrokarburet e absorbueshëm.

Frekuenca e matjeve do të jetë 3 herë në javë gjatë fazës ndërtimore.

### **Analizat e ujit**

Gjatë stadi ndërtimor do të ishte e nevojshme të analizohen vetëm pak parametra në pikat e shkarkimit, pas kalimit në filtër rëre ose në pellg precipitimi:

- UV 254 për ndotës që shfaqen gjatë ndërtimeve (naftë, benzinë, graso dhe substanca të tjera që varen prej materialeve të përdorura).

Analizat duhet të kryhen 1 herë në muaj ose siç e shikon të nevojshme ekipi monitorues.

Gjatë stadi të zbatimit duhet të analizohen më shumë parametra, por vetëm kur uji është i përshtatshëm (gjatë stineve me shi ose reshje, pas një stine me thatësiirë).

Parametrat që analizohen janë:

- UV 254;
- Hidrokarburet e ekstraktuar;
- Plumbi;
- Metalet e tjerë të rëndë (sipas kërkesës Cd, Cr);
- TOC (nëse është e mundur);
- pH;
- Përcjellshmëria.

Monitorimi duhet të kryhet për të kontrolluar nëse janë adoptuar masa zbutëse dhe efektiviteti i tyre.

Gjatë hartimit të P.D.V do të monitorohet për të kontrolluar nëse projekti në specifikimet e tij ka përfshirë masa të përshtatshme për të minimizuar ndikimet negative dhe që mundësojnë uljen e humbjes së drurëve dhe bordurave të gjelbëra. Kjo formon pjesën e procedurës të “ Sigurisë Cilësore ” të Konsulentit. Kushtet e duhura të zbatimit të kontraktuesit dhe sheshet e ndërtimit duhet të monitorohen here pas here për të siguruar që masat mbrojtëse mjedisore po zbatohen.

Përveç kësaj duhet të ketë një vëzhgim sistematik të përditshëm në gjithë vendet e aktiviteteve, sidomos në sheshet e ndërtimit dhe në vendet e sistemimit të mbetjeve, për të siguruar që kërkesat e kontratës për problemet mjedisore të përmbushen.

## **MENAXHIMI MJEDISOR**

### **Konsiderata të përgjithshme**

Në kontekstin e P.D.V. menaxhimi mjedisor lidhet me zbatimin e masave të nevojshme për të pakësuar dhe mënjanuar ndikimet negative dhe rritjen e ndikimeve përfituese. Për të qenë efektiv, menaxhimi mjedisor duhet të jetë plotësisht i integruar në përpjekjet e përgjithshme të menaxhimit të projektit në të gjithë nivelet, me synim kryerjen në nivel të lartë të kontrollit të cilësisë, si dhe zbatimin dhe funksionimin efektiv të projektit.

### **Faza e projektimit**

Menaxhimi mjedisor i projektit do të lidhet me katër grupe kryesore të aktiviteteve:

- Përgatitja e hollësive të projektit, bazuar në procedurat që synojnë në minimizimin e ndonjë ndikimi keqësues ose përfshirjen e ndikimeve përfituese;
- Përgatitja e dokumenteve kontraktuese të ndërtimit dhe të tenderave, që përmbajnë klauzola të përshtatshme të ndikimeve që vijnë prej veprimtarive ndërtimore;
- Rishikimi dhe përditësimi i monitorimit mjedisor dhe plani menaxhues të përfshijnë ndonjë amendament që mund të dalë gjatë fazës së hollësishme të skicimit (hartimit);
- Zbatimi i procedurave të shpronësimit të tokës dhe pronave, përfshirë pagesën e kompensimit.

### **Faza e ndërtimit**

Shumica e veprimtarive të menaxhimit mjedisor të projektit të P.D.V do të kryhet gjatë fazës ndërtimore, kur mund të priten të dalin shumica e ndikimeve. Menaxhimi do të lidhet me ndikimet kontrolluese që mund të rezultojnë prej veprimeve të kontraktuesit, përmes forcimit të kushteve të kontratave ndërtimore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Përsa i takon kësaj, zbutje e suksesshme e ndikimit ndërtimor mund të arrihet vetëm nëse masat mbrojtëse mjedisore siç dalin në kontratën ndërtimore, janë përforcuar si duhet.

Përgjegjësia e plotë për supervizionin e ndërtimit, menaxhimin e kontratës dhe menaxhimi mjedisor gjatë ndërtimit do të ketë të bëjë me Konsulentin. Klienti do të mund të marrë në punë një nënkontraktues si Institutin e Shëndetit Publik për veprimtaritë monitoruese.

Sidoqoftë, autoritet që kanë të bëjnë me supervizionin e përditshëm, do t'ja delegojnë inxhinierit vendas. Nëse kërkohet prej Klientit, një ekspert mjedisor do të mund të kryente kontroll për të mbështetur Konsulentin dhe ekipin vendor të tij.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar vendosjes së procedurave me anë të të cilave aksionet emergjente mund të merren prej stafit vendor në rastin e zëvendës kontraktuesit të papërgjegjshëm që mund të shkaktojë dëm mjedisor imediat dhe të konsiderueshëm (për shembull probleme që shoqërohen me kontaminimin e tokës, ujrave nëntokësore e sipërfaqësore prej përdorimit të papërshtatshëm të substancave të kontaminuara).

### **Faza e zbatimit dhe mirëmbajtjes**

Përfitimet nga zbatimi i projektit të Planit të Detajuar Vendor të zones në studim do të arrihen kur ai të kryhet në kohën e duhur. Menaxhimi dhe monitorimi mjedisor do të jetë përgjegjësi e Klientit.

**3.e) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot e peraferta per rehabilitimin.**

Ne fund te aktivitetit, investitori do te procedoje me sigurimin dhe restaurimin mjedisor te zones. Keto nderhyrje mund te konsiderohen perfundimtare, per t'a kthyer zonen te mundeshme per perdorimet e parashikuara nga organet e urbanistikes.

Plani i Restaurimit Mjedisor i zones se perdorur, ne zbatim te mbylljes se aktivitetit, do t'i referohet objektiveve te rimbledhjes dhe sistemimit te zones sipas drejtimet te perdorimit te parashikuar per vete zonen e Bashkise se interesuar.

Plani i Restaurimit Mjedisor ka vleren e shkaterrimit dhe kthimit te zones mbas verifikimit te mungeses se ndotjes, ne pajtim me dispozitat e Aneksit V (perqendrim ne prak te ndotjes ne siperfaqen e dheut, te nendheshme dhe ne ujrave nentokesore). Me restaurim mjedisor nenkuptohen nderhyrjet e rizhvillimit mjedisor e te paisazhit, dhe perberesit e nderhyrjes se bonifikimit apo te venies ne siguri te perhershme, qe bejne te mundur rekuperimin e siperfaqes per perdorim efektiv dhe perfundimtar per vete qellimin e perdorimit.

Per zhvillimin e hetimeve mjedisore do perdoret nje model konceptual paraprak, i cili do te realizohet mbi bazen e informacioneve historike te disponueshme para fillimit te planit te hetimit, si dhe ndonje hetim te mundshem te kryer ne matricat e ndryshme mjedisore pergjate menaxhimit normale te siperfaqes. Me modelin konceptual paraprak, do te pershkruhen karakteristikat e objektit ne kushtet e burimeve potenciale te ndotjes, karakteristikat dhe cilesite paraprake te matricave mjedisore ndikuar nga prania e aktivitetit te kryer ne kete objekt, rruget e mundshme te migrimit te burimeve te ndotjes drejt objektiveve te identifikuar. Nje model i tille do perpunohet para zhvillimit te aktivitetit ne terren. Per perpunimin e mevonshem te modelit konceptual paraprak, do pergatitet nje plan hetimi qe do te kete objektivin te verifikojte ekzistencen e ndotjes se tokes dhe ujrave nentokesore, te identifikojte rruget e mundshme te shperhapjes dhe migrimit te ndotesve, rindertimi i karakterislikave gjeologjike dhe hidrologjike te zones. Ne planin e hetimit do te evidentohen burimet potenciale te ndotjes qe perfshijne: ambienti i akumulimit dhe magazinimit te mbetjeve te materialeve, vaskat jasht toke, puset, mbledhjet e mbetjeve ne konteniere apo te shperndare, tubacionet dhe kanalizimet, etj.

Zbatimi i rehabilitimit dhe sigurise se zonave te ndotura sipas asaj qe eshte vendosur ne Shtojcen II (Kriteret e pergjithshme ne zgjedhjen dhe ekzekutimin e nderhyrjeve ne bonifikimin dhe restaurimin e mjedisit, masat e sigurise, si dhe per te identifikuar teknikat me te mira te nderhyrjeve me kosto te ulet). Rehabilitimi i nje zone te ndotur do te synoje ne eliminimin e ndotjeve nga matricat per te reduktuar perqendrimet e ndotesve ne toke, nentoke, ujrave nentokesore dhe siperfaqesore brenda vlerave te vendosura kufi te ndotjes (PML - perqendrimi minimal i lejueshem) te percaktuara per perdorimin e parashikuar. Nderhyrjet per sigurine, do te finalizohen ne heqjen dhe izolimin e burimeve ndotes dhe kontrollin e perhapjes se ndotesve ne kontakt me njerezit dhe receptoret mjedisore perreth.

**3.ë) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis.**

*Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore*

Per masat zbutese do te konsiderohet vetem faza e punimeve te parashikuara nga projekti. Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit. Gjate fazes se ndertimit nevojitet te ndermerren nje sere masash nga subjektet ndertuese dhe menaxhim nga Bashkia e Beratit.

*Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit*

1	Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit (aerosole)	Mjetet e transportit duhet te levizin te mbuluara gjate transportit te ngarkeses, mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht nga balta para daljes se tyre nga kantieri.
2	Emetim gazesh nga automjetet qe do kryejne punimet	Sasia do te jete minimale por duhet te punohet me eficence dhe te ulet koha e mbajtjes ndezur pa qene nevoja e motoreve te mjeteve. Te perdoret nafta DI per mjetet e transportit.
3	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen tubat e shkarkimete gazeve te mjeteve te cilet ne rast se cahen apo demtohen guarnicionet emetojne zhurma mbi nivelet teknologjike te tyre. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve. Te kufizohet koha e punimeve sidomos e shembjeve dhe hapjes se themeleve vetem gjate oreve te dites pasi shkakton zhurme dhe vibrime.
4	Shtim i trafikut rrugor	Te organizohet levizja e mjeteve kur hyjne dhe dalin nga kantieri nemenyre te tille qe qe mos te krijojne veshtiresi ne trafikun rrugor. Rekomandohet te drejtohen automjetet nga dalja e kantierit ne menyre te tille per shmangien e aksidenteve.

*Menaxhimi i mbetjeve te ngurta*

Administrata dhe punonjesit e kantierit do t'i kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga dispersiteti i mbetjeve te ngurta urbane, mbetjet ndertimore etj. Ne mjediset e kantierit duhet te vendosen kazane te grumbullimit te mbetjeve urbane te krijuara nga veprimtaria e kantierit. Mbetjet qe mund te riciklohen duhet te grupohen ne menyre te diferencuar per t'i marre ricikluesi me pas. Mbetjet e tjera shoqeria i depoziton ne vendgrumbullimin e mbetjeve tezones. Per sa i takon mbetjeve ndertimore ato duhet te menaxhohen ne bashkepunim me Bashkine e Lushnjes.

*Menaxhimi i mbetjeve te lengeta*

Ujerat sipërfaqesore te sheshit te punes duhet te orientohen ne sistem kanalizimesh dhe te derdhen ne sistemin e ujerave te zeza te sistemit. Ujerat e zeza te gjeneruara nga kantieret e aktivitetit ndertimor duhet te terhiqen nga shoqeri te specializuara per kete pune.

*Menaxhimi i shkarkimeve te gazta*

Duhet te kontrollohen ne menyre periodike gjendja e mjeteve te renda te transportit dhe te shkarkimeve te tyre. Nese shkarkimet e tyre nuk jane brenda normave do t'i nenshtrohen rregullimit ne servis.

*Masat per minimizimin e ndikimit ne trafikun e zones*

Gjate punimeve si per ndertimin e objektit te ri ashtu edhe ne nderhyrjet e infrastruktures rrugore te zones shoqeria qe kryen punimet nevojitet te marr persiper te organizoje levizjen e mjeteve te transportit ne menyre te tille qe te mos shkaktoje rendim ne trafikun e zones.

*Mbjellja e sipërfaqes se rezervuar per gjelberim (Rivegjetacioni)*

Ne te gjitha rastet kur verehet:

- prerje te drureve ne vendin e ndertimit,
- hedhje te dheut ne anet e prones,
- gerryrje te mundshme.

Kompania e kontraktuar detyrohet qe te realizoje mbjellje te bimeve dhe ne rastin e dherave te kryeje sheshimet e duhura dhe mbjelljen e tyre me bimesi lokale. Kjo gje do te ndihmonte ndjeshem ne eliminimin e demtimeve dhe rehabilitimin e peisazhit.

*Menaxhimi i hidrokarbureve ne kantier*

Veprimtaria e ndertimit bazohet ne perdorimin e mjeteve qe punojne me motore me djegie te brendshme, qe natyrisht kane nevoje edhe per lubrifikante. Ne kete rast rekomandojme:

- Ndonese ne projekt nuk behet fjale per ndonje depo karburanti ose lubrifikanti brenda territorit te kantierit, ne te ardhmen dhe gjate gjithë veprimtarise se ndertimit ne asnje rast dhe per asnje arsye nuk duhet te ndertohen depo karburanti ose lubrifikanti.

Per te menjauar ne maksimum riskun e rrjedhjeve aksidentale te karburantit e te lubrifikanteve:

- Investitori nuk duhet te lejoje te perdoren makineri te vjeteruara apo te demtuara.
- Mjetet motorike duhet te furnizohen me karburant e lubrifikant jashte territorit te kantierit.
- Personeli perkates te udhezohet e te pajiset me mjetet e duhura, ne menyre qe edhe ne rast avarish aksidentale te automjeteve qe shoqerohen me rrjedhje te karburantit e te lubrifikantit, te jete ne gjendje t'i menjanojne ato shpejt dhe pa pasoja.

*Plani i menaxhimit mjedisor*

Gjate Fazes se Ndertimit	Aktivitetet	Efektet	Masat per zbutjen e ndikimit	Komente
Kantieri	a) punime germime, furnizim vendosje tubash b) Mbushje ngjeshje, kthim ne gjendje te meparshme dhe pastrimi i territorit nga mbetjet	a) Ngritje pluhuri b) Pluhur	a) Perdorimi i paisjeve te pershtatshme dhe te teknologjise se re. b) Lagia e terrenit para punimeve. pajisje qe kryejne procesin shpejt dhe pa ndotje.	Percaktohn ne kontrate, Pergjegjesie specifikeve teknike
Transport materialesh	a)Materiale inerte b) Drure ose mbetje organike c) Beton te pergatitur ne pikat e licencuara d) Menaxhim trafiku e) Transport dherash si pasoje e germimeve	a) Ngritje pluhuri b) Erera te keqija te mundeshme c) Zhurme, shqetesime nga levizjet e makinave d)Pluhur, zhurme	a) Te perdoren mbulesa perkamionet b) Te aplikohet metoda e lagies me uje te rruges dhe kantierit c) Transporti te mos kryhet ne oret me trafik te ngarkuar dhe te shmangen rruget kryesore dhe ato qe kalojne ne zona te banuara	Percaktohen ne kontrate. Pjese e specifikeve teknike
Vendi i ndertimit	a)Demtime te tokes b) Karpenteri c)Betonim d) Vibrim i betonit e) Zhvendosja e banoreve f) Shqetesime nga zhurma e banoreve dhe kafsheve, si dhe punetoreve perreth g)Tekufizohen aktivitetet gjate oreve te nates dhe kohes se pushimit.	a)Humbje e shtreses siperfaqesore, demtime te tokes, shembje dherash, erozion, shplarje siperfaqesore b) Zhurmat per njerezit dhe kafshet c) Pluhur d) Vibrime si pasoje e makinerive te renda e) Crrregullime ne trafik.f) Ndotje e ujit dhe tokes si pasoje edepozitimeve g) Ndotje te ujit dhe tokes si pasoje e aksidenteveh)Siguria e punetoreve i)Mundesi zbulimi te elementeve me interes kulturor dhe	a) Te ruhen sa me teper zonat qe nuk do te ndertohet dhe te rehabilitohen me siperfaqe te gjelbra dhe drenazhim b) Te shmangjet punimi ne oret e vona, ditën e diele te behet pushim, te perdoren makineri me impakt te ulet akustik c) Perdorimi i ujit dhe materialeve te pershtateshme d) Kushtezimi ne oret e punimeve me orare jo te demshme te konsultuara me njesine vendore e) Marrja e masave perkatese ne konsultim me policine rrugore.per vendosjen e rregullave te qarkullimit	Te zbatohen rregullat e percaktuara nga institucionet perkatese, si psh AgjensiaRajonale e Mjedisit

		historikpercaktuara nga institucionet perkatese, si psh Agjensia Rajonale e Mjedisit	f) Mbetjet e ngurta te hidhen ne pikat e caktuara nga pushteti vendor dhe te mos grumbullohen ne kantier;gjate qendrimin ne kantier te sigurohet qe te mos kene shplarje nga ujrat siperfaqesore dhe te mos ekspozohen ndaj erez g) Te pajisen punetoret me veshjembrojtese,skafandra, rripa sigurimi dhe mjete ndricimi.Te vendosen tabela paralajmeruese per rastet me rrezik ne kantierin e ndertimit. h)Pezullimi imenjehershem i punimeve dhe venia ne dijen e autoriteteve perkatese.
Mirmbajtja	b) Transformim e hapësirave komerciale ne ambiente pune	a) Ndotje te mundeshme te ujit dhe tokes nga rrjedhje te mundshme te lendeve te demshme per mjedisin b)Grumbullimi i mbeturinave te aktivitetit te objektit d) Siguria e punetoreve dhe banoreve te zones	b) Te sigurohen vende te sigurta per depozitim e lendeve te demshme per mjedisin, si psh lubrifikante, lende djegese etj c) Te caktohet nje kontenier per grumbullimin e mbeturinave te objektit, ne vende te aprovuara nga njesite vendore; te behet ndarja e mbeturinave d) Objekti te paiset me sistem te mbrojtjes kunder zjarrit dhe me depozita te vecanta per emergjenca
Shfrytezimi	a)Shfrytezimi i ambienteve sportive dhe te pushimit b) Shfrytezimi i ambienteve per femije	Krijimi i mbeturinave urbane si pasoje e aktivitetit human dhe aktiviteteteve te sherbimit ne katet perdhe, demtimi i siperfaqeve te gjelbra, etj.	Te behet grumbullimi i mbeturinave ne vendet e percaktuara nga njesia bendore, te mirembahen zonat e gjelberuara, etj.

**3.f) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar ( nese projekti ka natyre te tille).**

Nuk do te kete ndikime nderkufitare pasi projekti do te zhvillohet Brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

**Punoi Raportin e VNM-se Paraprake:**

**MSc. Inxh Raimina Hakrama**

**Eksperte Mjedisit**

